



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXV / Nr. 04 / Prill 2026



Bindjani
Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ



“DRITA ISLAME”

Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmshe.al

Viti XXXV i botimit

Nr. 04 (514)


Prill, 2026

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al





editorial

04 Dita që lindi Dita që lindi Profeti Muhamed
Mehmet Disha

në fokus

06 Fjala përshëndetëse e kryetarit të KMSH, në programin artistik "Profeti Muhamed (a.s.), Krenaria e Njerëzimit"

lajme / aktivitete

08 **01-Së bashku në mirësi**
02-Nënkryetari i KMSH-së, z. Lauren Luli, zhvilloi një vizitë në xhaminë e Flumsit në Zvicër
03-Besimtarët myslimanë festojnë Fitër Bajramin
04-Zhillohet ceremonia e nisjes së projektit për shpërndarjen e hurmave arabe
05-Zyra e Haxhit dhe Umres në KMSH, shtroi një iftar me një pjesë të haxhinjve ndër vite

refleksione

14 Përvjetori i lindjes së Hafiz Ali Korçës dhe varri i tij në Kavajë / Ledian Cikalleshi

çështje fetare

16 Leasing në këndvështrimin Islam
Këshilli për Çështjet Fetare - insi.al

familja

20 Të jetosh i lirë... deri ku?
Leonard Çela

horizonti i besimit

22 Bujqësia, xihadi dhe shpëtimi ynë
Tauland Bica

24 Rëndësia dhe qëllimi i Haxhit
Lauren Luli

26 Sakrifica e kurbanit, përkujdesje ndaj njeriut
Dorian Demeđa

28 Pesë dhunti
Veton Tulla

30 Zoti i Frikës apo i Mëshirës - Një reflektim mbi ligjërimitin fetar, shpirtin njerëzor dhe perceptimin tonë rreth Zotit / Ana Haxhiu

bota shpirtërore

32 Haxhi është m'e madheja pasqyrë për demokrasinë muslimane / Hafiz Ali Korça



34 Grueja në myslimanizmë
Redaksia

hapësirë feminare


36 Këshilla
Hapësire Feminare

këndi i poezisë

38 Poezi kushtuar Profetit Muhamed a.s.
Vexhi Buharaja



Dita që lindi **Profeti Muhamed**



Ndodhitë e mrekullishme që nisën të ndodhnin në kohën e lindjes së Profetit nuk ishin të kufizuara vetëm brenda shtëpisë. Edhe në qiell po ndodhnin gjëra të çuditshme. Në Mekë jetonte një dijetar që merrej me shkencën e yjeve. Natën që lindi Profeti, atij i kishte bërë përshtypje një yll i ri, të cilin nuk e kishte parë kurrë më parë. Në mëngjes ai filloi t'u zinte rrugën Kurejshëve duke i pyetur:

- A ju ka lindur mbrëmë ndonjë djalë në lagjen tuaj?

- Nuk e dimë, - i thoshin ata.

- Atëherë shkoni menjëherë dhe pyesni, - i porositi ai, - sepse dje kam parë yllin e lindjes së profetit të fundit të njerëzimit. Në shpinë ai ka një shenjë që i takon pikërisht profetit të fundit.

Kurejshët pyetën gjithandej dhe u kthyen përsëri te dijetari hebre duke i thënë:

- Dje ka lindur djali i Abdullahut, madje e ka edhe shenjen që ju na treguat.

Hebreu që nuk donte t'u besonte veshëve, deshi të shkonte e ta shikonte këtë fëmijë me sytë e tij. U bë si i çmendur kur e pa edhe shenjen me sytë e tij. U largua prej andej me vrap dhe bërtiste:

- Kurejshëve do t'u vijë një shtet i atillë, që zëri do t'i shkojë prej skajit të Lindjes deri në atë të Perëndimit. Profetësia iku prej hebrejve. Iku.

Pas lindjes, lajmi i mirë iu dërgua edhe gjyshit të foshnjës. Abdulmutalibi, i cili gjendej në Qabe në atë kohë, me të dëgjuar këtë sihariq, rendi menjëherë drejt shtëpisë. E mori fëmijën në krahë dhe zuri ta puthte me dashuri. E mori fëmijën me gjithë djep dhe shkoi me të në Qabe për të falënderuar Allahun. Kur u kthye, nëna e Profetit, Amina, i tregoi për ëndrrën në lidhje me vendosjen

e emrit të fëmijës, ndaj dhe e quajti Muhamed fëmijën e saj.

Një tjetër ngjarje që ndodhi teksa po lindte Profeti ynë i nderuar, ishte edhe shkatërrimi i katërmbëdhjetë shtyllave të pallatit mbretëror të persëve. Kisra, mbreti i tyre, së bashku me popullin e tij, pritën agimin për të mësuar se çfarë kishte ngjarë gjatë asaj nate. Kur u zgjuan, panë se katërmbëdhjetë shtyllat e pallatit ishin rrëzuar. Kisra mendoi të thërriste tempullarët e tij që t'i shpjegonin se pse kishin ndodhur të gjitha këto. Sapo ishin mbledhur priftërinjtë, kur ia behu një lajmëtar. Ai kishte ardhur të lajmëronte se ishte shuar zjarri, të cilin e adhuronin persët dhe që kishte shekuj të tërë që nuk shuhej. Kisra, me sytë e zmadhuar prej çudisë, iu drejtua kryepriiftit:

- Ç'do të thotë të gjitha këto?

Kryepriifti, i cili së afërmi kishte parë një ëndërr, ktheu këtë përgjigje:

- Kam përshtypjen se në vendet arabe do të ndodhin ngjarje shumë të rëndësishme.

Pastaj, me të pyetur, ata gjetën një vend, ku mund t'i jepnin përgjigje gjithë këtyre gjërave që po ndodhnin. Ky ishte një magjistar sirian me emrin Satiha, i cili nuk kishte kocka dhe e kishte kokën shumë më sipër trupit të tij.

Përgjigja e tij ishte e qartë dhe e shkurtër:

- Do të nisë të zbrësë kumtim prej qiellit me ardhjen e profetit të fundit, ndërsa Perandoria Perse, pas Perandorit të XIV, do të fshihet nga historia.

Me të vërtetë, pas kësaj ndodhie kaluan plot gjashtëdhjetë e shtatë vjet. Për sa kohë që në krye të vendit ishte Kisra i katërmbëdhjetë, fjalët e Satihut dolën të vërteta dhe pa asnjë lloj mangësie.



FJALA PËRSHËNDETËSE E KRYETARIT TË KMSH, NË PROGRAMIN ARTISTIK “PROFETI MUHAMED (A.S.), KRENARIA E NJERËZIMIT”

Të dashur vëllezër e motra,
Jemi në muajin që nuk është thjesht një faqe kalendari, por një frymëmarrje e historisë, muaji në të cilin toka u nderua me lindjen e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

Ky muaj vjen çdo vit, por a vijmë ne me të njëjtën etje shpirtërore për ta përjetuar?

Apo kalon si një puhizë e lehtë mbi jetët tona të rënduara nga harresa?

Sepse lindja e tij nuk është një rrëfim i largët, është një gjallëri që kërkon të zgjohet brenda nesh.

Ishte një botë e ashpër, një kohë ku ndërgjegjia njerëzore ishte mplakur, ku padrejtësia kishte zënë vend si një hije e rëndë mbi çdo horizont. Dhe pikërisht atëherë, Allahu i Madhëruar e dërgoi atë si mëshirë për botët. Siç thuhet në Kuran: **“Ne nuk të kemi dërguar ty veçse mëshirë për botët.”** (El-Enbija, 107)

Ai erdhi pa mburojë tjetër përveç besimit, pa pasuri tjetër përveç së vërtetës.

U rrit jetim, por me një shpirt që nuk u përkul kurrë para padrejtësisë. Ai ishte i butë, por i pathyeshëm; i përlulur, por madhështor në karakter.

Njerëzit e quajtën “El-Emin”, besniku, sepse në një botë të mbushur me mashtrim, ai ishte si një burim i pastër në mes të shkretëtirës.

Dhe kur shpallja i zbriti, ai nuk u ngrit si një sundimtar që kërkon pushtet, por si një shërbëtor që bart një amanet të rëndë.

Allahu thotë: **“Vërtet, Ne do të të japim një fjalë të rëndë.”** (El-Muzzemmil, 5)

Dhe sa e rëndë ishte ajo fjalë! Ajo kërkonte durim kur përqeshej, të falte kur lëndohej, dhe qëndrueshmëri kur mbetej i vetëm.

Të dashur besimtarë,

Muhamedi (a.s.) nuk ishte vetëm një ligjërues i së mirës, ai ishte mishërimi i saj. Ai jetonte atë që predikonte. Ai ishte Kuran që ecte mbi tokë.

Në një hadith përshkruhet se kur u pyet për moralin e tij bashkëshortja, ajo tha: *“Moralin e tij ishte Kurani.”*

Çfarë do të thotë kjo për ne?

Do të thotë se çdo ajet që lexojmë, ai e kishte kthyer në jetë. Çdo urdhër që dëgjojmë, ai e kishte zbatuar me përpikëri dhe dashuri.

Ai thoshte: *“Më i miri prej jush është ai që ka moralin më të mirë.”*

Dhe në një tjetër hadith: *“Unë jam dërguar vetëm për të plotësuar moralin e lartë.”*

Pra, feja nuk është vetëm në fjalë, por në sjellje. Nuk është vetëm në lutje, por në drejtësi. Nuk është vetëm në ritual, por në marrëdhënie me njerëzit.

Ah, sikur ta kuptonim këtë thellë!

Sa herë që zemra jonë ngurtësohet, le të kujtojmë butësinë e tij. Sa herë që zemërohemi, le të kujtojmë durimin e tij. Sa herë që kemi mundësi të hakmerremi, le të kujtojmë faljen e tij.

Allahu thotë: **“Ti je vërtet në një shkallë të lartë morali.”** (El-Kalem, 4)

Ky është vlerësimi hyjnor për të dhe ky është standardi që na fton ta ndjekim.

Të dashur miq,

Përkujtimi i lindjes së të dërguarit të Allahut nuk kërkon nga ne vetëm fjalë të bukura. Ai kërkon një kthesë të brendshme. Kërkon që të ndalemi dhe të pyesim veten: sa prej jetës sonë i ngjan jetës së tij?

Ajemi ne bartës të mëshirës, apo shpërndarës të ashpërsisë?

Ajemi ne ndjekës të së vërtetës, apo robër të interesit?

Sepse dashuria për të nuk matet me lavde, por me ndjekje.

Allahu thotë: **“Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë.”** (Ali Imran, 31)

Sa e qartë është kjo rrugë! Dashuria për Allahun kalon përmes ndjekjes së të Dërguarit të Tij.

Prandaj le të mos mjaftohemi me kujtim, por ta kthejmë atë në ndryshim. Le të bëhemi më të drejtë në fjalë, më të ndershëm në punë, më të mëshirshëm në sjellje.

Sepse ndoshta, pikërisht atëherë, lindja e tij do të marrë kuptim të ri në jetën tonë, jo si një ngjarje e kaluar, por si një dritë që vazhdon të lindë brenda nesh.

Allahu na bëftë prej atyre që e duan me sinqeritet dhe e ndjekin me përkushtim.

Amin!

01 SË BASHKU NË MIRËSI



Myftinia e Sarandës organizoi simpoziumin me temë “Së bashku në mirësi”, një aktivitet i cili u shoqërua edhe me një iftar të shtruar për besimtarët e qytetit të Sarandës dhe zonave përreth. Aktiviteti mbledhi së bashku besimtarë, imamë dhe përfaqësues të institucioneve fetare nga disa myftini të jugut të vendit, në një atmosferë vëllazërie dhe solidariteti gjatë muajit të bekuar të Ramazanit.

Në fjalën e tij hapëse, Myftiu i Sarandës, z. Bledar Mulla, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe theksoi vlerat e mëdha shpirtërore të agjërimit. Ai kujtoi se agjërimi është një adhurim i veçantë për Allahun, i cili shpërblehet drejtpërdrejt prej Tij, ndërsa u lut që Allahu (xh. sh.) t’i pranojë agjërimin, lutjet dhe adhurimet e besimtarëve gjatë këtij muaji të bekuar.

Të pranishmit i përshëndeti edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili vlerësoi organizimin e këtij aktiviteti dhe theksoi rëndësinë e Ramazanit si një periudhë reflektimi, pastrimi shpirtëror dhe afrimi me Zotin. Në fjalën e tij ai nënvizoi se agjërimi nuk është vetëm një përmbajtje fizike nga ushqimi dhe pija, por një edukim i shpirtit, një stërvitje e durimit dhe një rikthim tek mëshira, butësia dhe altruizmi.

Në këtë simpozium morën pjesë edhe myftinj të disa myftinive të jugut të vendit, si: Myftiu i Delvinës, z. Bledar Ali, Myftiu i Gjirokastrës, z. Ermir Gjana, Myftiu i Vlorës, z. Ardit Hoxhllaku, dhe Myftiu i Fierit, z. Mikel Hazizolli, të cilët mbajtën nga një ligjëratë të shkurtër.

Pas përfundimit të ligjëratave, besimtarët e shumtë u bënë pjesë e iftarit të organizuar nga Myftinia e Sarandës



02 NËNKRYETARI I KMSH-SË, Z. LAUREN LULI, ZHVILLOI NJË VIZITË NË XHAMINË E FLUMSIT NË ZVICËR



Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, zhvilloi një vizitë në Xhaminë e Flumsit në Zvicër, ku u prit nga kryetari i saj, z. Mensur Nuhiu, imami z. Veton Tulla, si dhe nga bashkëatdhetarë besimtarë që jetojnë e punojnë në vendin mik.

Gjatë qëndrimit të tij në Zvicër, nënkryetari Luli ndau disa iftare me xhematin e kësaj xhamie, ku gjithashtu i priu edhe në faljen e namazit të teravive.

Një moment i veçantë i kësaj vizite ishte dorëzimi i një certificate falënderimi për Xhaminë e Flumsit, në shenjë mirënjohjeje për kontributin dhe mbështetjen e dhënë në organizimin e aktivitetit fetar në Parma të Italisë.

Certificate falënderimi iu dorëzua gjithashtu edhe kryetarit të xhamisë, z. Mensur Nuhiu, si dhe imamit z. Veton Tulla, me të njëjtin motivacion, duke shprehur kështu vlerësimin dhe falënderimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për këtë bashkëpunim të frytshëm.

Kjo vizitë shënoi një tjetër hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit dhe lidhjeve ndërmjet institucioneve fetare shqiptare në diasporë.



03 BESIMTARËT MYSLIMANË FESTOJNË FITËR BAJRAMIN



Sot është një ditë feste për të gjithë ne, dita kur zemrat mbushen me gëzim, mirënjohje dhe paqe, duke shënuar përmbylljen e një muaji përkushtimi, sakrifice dhe reflektimi në rrugën e besimit.

Allahu e pranoftë agjërimin e muajit të begatë, lutjet, adhurimet dhe çdo vepër të mirë që kemi kryer me sinqeritet, duke synuar vetëm kënaqësinë e Tij.

Gëzuar Fitër Bajramin!

Mijëra besimtarë myslimanë të kryeqytetit falën sot namazin e Fitër Bajramit në sheshin "Skënderbej" në Tiranë dhe mijëra të tjerë u tubuan në sheshet dhe xhamitë kryesore të çdo qyteti tjetër të vendit tonë, duke festuar kështu përfundimin me sukses të një muaji maratonë në aspektin e adhurimeve.

Programi i Fitër Bajramit në shesh filloi që në orët e para të mëngjesit me leximin e disa ajeteve nga Kur'ani Famëlartë, të cilat u përcollën për besimtarët e pranishëm nga imami i xhamisë "Et'hem Bej", z. Elton Karaj.

Fill pas leximit të Kuranit Fisnik, ishte radha e fjalës përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili theksoi rëndësinë shpirtërore të muajit të Ramazanit si një periudhë pastrimi, përlësie dhe forcimi të lidhjes me Zotin. Kryetari kujtoi gjithashtu rëndësinë e paqes, drejtësisë dhe bashkëjetesës, duke përmendur edhe vuajtjet në botë dhe nevojën për më shumë mirësi e mirëkuptim.





Programi i Fitër Bajramit vijoi me ligjëratën e rastit të mbajtur nga Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, i cili nënvizoi rëndësinë e mirësisë, faljes dhe ndarjes me të tjerët, sidomos me ata në nevojë, si dhe rolin e sadakasë në përhapjen e gëzimit të festës.

Programi kulmoi me faljen e namazit të Fitër Bajramit, ku mijëra besimtarët e mbledhur në shesh i priu Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Spahiu, për të vazhduar më pas me hutben e Bajramit, e cila u mbajt nga Myftiu i Tiranës, z. Bilal Teqja.

Gjatë hutbes, z. Teqja e vlerësoi Bajramin si një ditë gëzimi, triumfi dhe shpërblimi hyjnor për përkushtimin e treguar gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit. Në këtë frymë, ai uroi që kjo festë të shërbejë si një moment reflektimi dhe afrimi mes njerëzve, duke nxitur dashurinë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në shoqëri.

Më pas, besimtarët e pranishëm në shesh u shpërndanë për të festuar me familjet dhe të afërmit e tyre.



04 ZHVILLOHET CEREMONIA E NISJES SË PROJEKTIT PËR SHPËRNDARJEN E HURMAVE ARABE



Ditën e sotme, në ambientet e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, u zhvillua ceremonia e nisjes së projektit për shpërndarjen e hurmave arabe, një iniciativë e zhvilluar nga Qendra Mbreti Selman (KSrelief), në koordinim me Ambasadën e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Ky projekt përfshin shpërndarjen e 25 ton hurmave si dhuratë nga Shërbëtori i Dy Xhamive të Shenjta, Mbreti Selman bin Abdulaziz Al Saud për besimtarët në Republikën e Shqipërisë.

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Shqipëri, z. Fajsal Gazi Hifdhi, si dhe znj. Tajibah el-Rashidi, përfaqësuese e KSrelief.

Gjatë aktivitetit u mbajtën fjalime përsëritëse, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit për zbatimin e projektit dhe u realizua një shpërndarje simbolike e disa pakove me hurma për përfituesit.

Ky projekt pasqyron frymën e solidaritetit dhe vëllazërisë, si dhe marrëdhëniet e mira mes Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite, duke theksuar rolin humanitar të Mbretërisë në mbështetjen e komuniteteve në mbarë botën.



05 ZYRA E HAXHIT DHE UMRES NË KMSH, SHTROI NJË IFTAR ME NJË PJESË TË HAXHINJVE NDËR VITE



Zyra e Haxhit dhe e Umres pranë Komunitetit Mysliman i Shqipërisë, mbrëmjen e sotme zhvilloi në ambientet e "Tirana International Hotel" një iftar të përbashkët me një pjesë të haxhinjve shqiptarë ndër vite, duke mbledhur së bashku dhjetëra besimtarë e besimtare nga qytete të ndryshme të vendit.

Të pranishëm në këtë mbrëmje ishin Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe njëkohësisht koordinatori i Haxhit, z. Lauren Luli, përfaqësues të tjerë të Zyrës së Haxhit dhe Umres, si dhe murshidë e hoxhallarë që ndër vite kanë shërbyer dhe kanë qenë pranë haxhinjve shqiptarë gjatë qëndrimit të tyre në vendet e shenjta.

Në fjalën e tij përshëndetëse, z. Luli u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe ndau me ta disa kujtime të përbashkëta nga vizitat në vendet e shenjta. Ai gjithashtu uroi që agjërimi dhe adhurimet e këtij muaji të begatë të pranohen nga Krijuesi i Gjithësisë për të gjithë besimtarët.

Më pas, të pranishmit i përshëndeti edhe znj. Dhurata Milaqi, me një poezi kushtuar këtij muaji të shenjtë, duke theksuar rëndësinë shpirtërore dhe vlerat që ai përcjell për besimtarët.

Mbrëmja vijoi më tej me konsumimin e iftarit të përbashkët dhe me rikujtimin e momenteve të paharrueshme gjatë kryerjes së ritualit të Haxhit në vendet e shenjta.



Përvjetori i lindjes së Hafiz Ali Korçës dhe varri i tij në Kavajë

Në muajin prill, kujtojmë ditën kur u lind dijetari Hafiz Ali Korça, më 5 prill 1873, në Korçë, i cili është një ndër figurat më të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, duke kontribuar në përhapijen e arsimit shqip dhe në forcimin e ndërgjegjes kombëtare. Gjithë jetën e tij ia kushtoi fesë dhe atdheut. Midis vuajtjeve të shumta, tragjedive familjare, internimeve, skamjeve dhe sëmundjeve të pleqërisë, ai do të ndërronte jetë më 31.12.1956, në Kavajë. Populli i Kavajës, i cili e mbajti dhe e përkrahu, pavarësisht presioneve dhe përndjekjeve të sistemit diktatorial komunist, do ta përcillte me lutje dhe nderime. Por, si përfundoi Hafiz Ali Korça në Kavajë?

Hafiz Ali Korça njihet si kritik ndaj çdo sistemi që punonte kundër interesave kombëtare të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Veprimtarinë patriotike për alfabetin e miratuar në Kongresin e Manastirit, Hafiz Ali Korça, do ta vijonte me pjesëmarrjen e tij aktive në Kongresin Kombëtar të Elbasanit të zhvilluar më 2-9 shtator 1909.

Nga Korça ishte larguar po për këtë arsye, pasi xhonturqit, të cilëve nuk iu pëlqeu veprimtaria e Hafizit gjatë kongresit e quanin atë "latinxi". Ata kishin udhëzuar njerëz nga qyteti i Korçës që ta godisnin fshehurazi dhe në mënyrë të vazhdueshme shtëpinë e tij, të cilën pas disa muajsh e shndërruan në të pabanueshme. Kur Hafiz Ali Korça bënte denoncim në lidhje me këtë gjë te institucionet e sigurisë së kohës, ata talleshin dhe i thoshin me ironi, se mbase t'i hedhin shejtanët gurët për shkak se përkrah shkronjat latine të shqipes.

Ende pa u çliruar Shqipëria, Hafiz Ali Korça u shpërngul në zonën e Shijakut dhe Durrësit. Nga viti 1910-1916 pati banuar në Shijak, ndërsa më vonë për disa vite u shpërngul në Shkodër deri në vitin 1922. Më pas u kthye në Tiranë, ku shërbeu për rihapijen dhe themelimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, përkrah Haxhi Vehbi Dibrës.

Ndër veprat që shkroi, dy vepra i kanë kushtuar shtrenjtë Hafiz Ali Korçës, për shkak të përmbajtjes politike që kishin dhe mesazheve që ato përcillnin për kohën që jetoi. Vepra e parë ishte, "Shtatë ëndrrat e Shqipërisë" e botuar për herë të parë në vitin 1924¹. Në këtë vepër janë 7 ëndrra dhe 7 shpjegime që Hafiz Ali Korça ua drejton politikanëve shqiptarë gjatë viteve '20, që nuk po ndërgjegjësoheshin për rrezikun që i kanosej Shqipërisë nga pushtuesit dhe copëtimi. "Si një atdhetar idealist për t'ua sjellë ndërmend asamblistëve se rruga që kanë kapur nuk po i shpie në Kabe

1. Vepra "Shtatë ëndrrat e Shqipërisë" u botua ribotua sërish më 1944, sa ishte gjallë vetë hafizi. Më pas ajo vepër ngeli e fshehur nga sistemi komunist, kur u ribotua sërish për herë të tretë në Tiranë, në vitin 2006, pas 62 vitesh.

(Qabe), por në shkretëtirë, shkruajta këto Shtatë Ëndrrat dhe pasi i shtypa vetëm njëqind copë ua dhashë nga një duke iu thënë: Sot fati i Shqipërisë është në duart tuaja. Në qoftë se shtetit do t'i hidhni një themel të mirë duke zgjedhur burra të mirë e të drejtë, nëse do të çelni një Bankë Kombëtare me të hollat e kapitalistëve shqiptarë dhe nëse fëmijët do t'i rritni me ndjenja kombëtare e fetare, atëherë do të jeni të lumtur e të lavdëruar, përndryshe pas 15 ose 20 vitesh, kur të realizohen këto shtatë ëndrrat e tmerrshme do të bëheni pishman, por nuk do t'ju bëjë dobi". Këto ëndrra në formë poezish Korça i shkroi në vitin 1923 në prag të Kongresit të Lushnjës dhe i ribotoi sërish në qershor të vitit 1944, në prag të çlirimit nga nazi-fashizmi dhe në vigjilje të një tjetër periudhe të errët për vendin dhe popullin tonë.

Kjo vepër ishte cilësuar si kritikë ndaj qeverisë së Zogut dhe për këtë arsye ai i kishte bërë presion të madh Komunitetit Musliman, duke e lënë jashtë çdo posti drejtues. Që nga viti 1924 e deri në vitin 1948 kishte punuar vetëm si mësues në Medresenë e Tiranës, të cilën e kishte bërë me pasion të madh dhe kishin dalë mjaft emra intelektualësh, si Vexhi Buharaja, Sadik Bega etj.

Hafiz Ali Korça gjatë periudhës së pushtimit nazi-fashist nuk kishte bashkëpunuar me pushtuesin. Një fakt është rasti kur, mëkëmbësi i Italisë fashiste në vendin tonë kishte marrë disa reforma në Komunitetin Mysliman gjatë pushtimit dhe më 9 qershor 1942, kishte vendosur krijimin e Këshillit të Ulemave në vend të Këshillit të Përhershëm e të Përgjithshëm të Komunitetit Musliman, ku si kryetar të Këshillit të Ulemave kishte caktuar Hafiz Ali Korçën, por ky i fundit nuk kishte pranuar duke dhënë dorëheqjen.

Vepra dytë e famshme e Hafiz Ali Korçës, shkruar që në vitin 1925 me pasoja për të, ishte ajo kundër komunizmit e titulluar "Bolshevizma a çkatërrim i njerëzimit". Me këtë vepër ai u shënjua si denoncuesi i parë shqiptar i komunizmit. Duke iu kundërvënë bolshevizmit dhe duke parandier ardhjen e një "reje të zeze" për Shqipërinë dhe shqiptarët, ai e godet fort atë që para instalimit të diktaturës komuniste, me vargjet:

Bolshevizma s'pajton kurrë
Me dinin e Muhammedit
Çelët do ta kenë luftën
Gjer ditën e Kijametit

Kur regjimi komunist u instalua në vitin 1945, këtë gjë nuk ia fali Hafizit dhe në vitin 1948 e internuan në Kavajë, ku edhe ndërroi jetë në vitin 1956.

Ai u varros në varrezat e vjetra të qytetit, ku sot është ish-

stacioni i trenit të Kavajës. Gjatë kohës së internimit atje, ai u strehua nga familja Dervishi dhe populli i Kavajës e ndihmoi atë dhe familjen e tij. Hafiz Ali Korça pavarësisht skamjes, vrasjes së djalit nga komunistët dhe moshës së thyer, nuk u dekurajua kurrë. Ai vazhdoi t'u mësonte në fshehtësi fëmijëve dhe të rinjve besimin islam dhe kishte lënë edhe disa nxënës. Njëri prej tyre, i cili tashmë njihet nga e gjithë Kavaja dhe jo vetëm, ishte i ndjeri Haxhi Xhafer Shkodra². Ai u bë drejtori i parë i Medresesë së Kavajës (1991-1998) dhe në shtator 1993, me iniciativën e tij, kësaj Medreseje iu dha emri "Hafiz Ali Korça".

Kur jam kthyer nga studimet në vitin 2009, kërkova për varrin e Hafizit, por pak veta e dinin. Nga interesimi më drejtuan për te Haxhi Xhafer Shkodra. I kërkova rahmetliut që të më çonte te varri i Hafizit dhe më shoqëroi, duke më rrëfyer shumë gjëra. Te varri i vjetër shkoja herë pas here dhe gjithmonë lexoja mbishkrimin te epitafi i lënë aty.

Hafiz Ali Korça

Kushdo që varrin të na vizitojë

Një Kulhuvallahu të na këndojë

Shpirtin tonë të na gëzojë

Në vitin 2010, ish-drejtori i Medresesë së Kavajës, z. Kasim Ilhan, pasi i kisha treguar fotot dhe gjendjen e varrit, më dërgoi që t'i kërkoja leje Haxhi Xhafës për ta rregulluar varrin, në mënyrë që të mos humbiste me kalimin e viteve. Por Haxhi Xhafa nuk pranoi, duke thënë me atë mënyrën e vet: "Ça e ka gjetur deri tani? E ka mbrojt Allahu."

Deri sa Haxhi Xhafer Shkodra ishte gjallë, ai u bë rojtari i varrit të tij dhe askush nuk e preku, as varrin dhe as truallin e pazaptuar ku ndodhej varri. Pasi ai ndërroi jetë në vitin 2016, te vendi përreth ku ndodhej varri i Hafiz Ali Korçës, u

2. Në lidhje me kujdesin e nxënësit të tij, përpjekjet e tij për të ruajtur varrin e Profesorit të tij, dikur pata shkruajtur një shkrim në Revistën Drita Islame me titull: HAFIZ ALI KORÇA – DIJETARIT QË NUK IA ZHDUKËN AS EMRIN AS VARRIN.



ndërtua një shtëpi dhe kështu rrezikonte që pas disa kohësh të zhdukej çdo gjurmë e varrit.

Çdokush që studjon veprat e Hafiz Ali Korçës krijon një lidhje shpirtërore me të, e cila bën që herë pas here ti shkosh te varri për ti bërë ndonjë dua shpirtit të tij. Ashtu si unë, një prej tyre që e vizitonte varrin e Hafizit ishte dhe orientalisti Ermal Bega, i cili është kujdesur për ribotimin e katër veprave të Hafiz Ali Korçës. Shkuarja e tij atë kohë në Kavajë, për të vizituar varrin e Hafiz Ali Korçës, u bë një nxitje që më pas të merreshin masat e ndryshme për rivarrimin e eshtrave të Hafiz Ali Korçës me respektin që meritonte.

Si përfundim, masat u morën, eshtrat e Hafiz Ali Korçës u nxorën dhe më 8 gusht 2017, në një ceremoni të vogël u bë rivarrimi i eshtrave të Hafiz Ali Korçës, në hyrje të varrezave publike në Kavajë, nën kujdesin dhe koordinimin e myftiut të Kavajës Besnik Leçini, me miratimin e familjarëve dhe mbështetjen e kryetarit të bashkisë të kohës, z. Isa Sakja. Në mbrëmjen e asaj dite në pallatin e kulturës në Kavajë u zhvillua edhe një takim përkujtimor për jetën dhe veprën e Hafiz Ali Korçës, morën pjesë, kryetari i KMSH-së, H. Skender Bruçaj, myftiu i Kavajës, z. Besnik Leçini, kryetari i bashkisë së Kavajës, z. Isa Sakja, nipi i Hafiz Ali Korçës, z. Ali Korça, myftinj, imamë, të afërm të H. Ali Korçës, studjues dhe qytetarë të qytetit të Kavajës.

Varri i Hafiz Ali Korçës sot gjendet përkrah nxënësit të tij, Haxhi Xhafer Shkodra, i cili ia kishte mbrojtur varrin gjatë gjithë jetës sa jetoi.

Kujtojmë se më 15 shkurt 2017, Presidenti i Republikës, i ndjeri Bujar Nishani, e vlerësoi dijetarin Hafiz Ali Korça pas vdekjes me dekoratën "Nderi i Kombit", me motivacionin:

"Për rolin dhe kontributin e tij të rëndësishëm e vetëmohues në dobi të çështjes kombëtare: si martir i kombit e kulturës shqiptare, si klerik atdhetar i shquar e veprimtar i flaktë për çlirimin e vendit nga zgjedha e huaj, si figurë e papërsëritshme intelektuale, duke u shndërruar në një nga dijetarët më të ndritur të filozofisë islame në Shqipëri."



Në foton e parë dallohet qartë gjendja e mjerueshme e vendit ku ndodhej varri i vjetër i Hafiz Ali Korçës (Kavajë, 11 korrik 2017)

LEASING NË KËNDVËSHTRIMIN ISLAM



Në radhë të parë ritheksojmë disa parime thelbësore:
– Çdo kontratë është e lejuar, për sa kohë që nuk përmban elemente të ndaluar nga feja islame.

– Një nga elementet më të rëndësishëm që e bën kontratën të pavlefshme është përfshirja e kamatës, gjë që është shumë e shpeshtë në sistemet financiare të sotme.

– Po ashtu, përfshirja në kontratë të elementeve që mund të bëhen shkak për konflikte apo mosmarrëveshje, si paqartësi apo hapësira të ndryshme të papërcaktuara, janë elemente që e bëjnë kontratën të palejuar.

– Pavarësisht se mund të ketë të njëjtin emërtim, çdo kontratë është unike dhe detajet e saj bëjnë diferencën me kontrata të tjera.

– Gjithsecili që interesohet të dijë nëse kontrata në fjalë është konform kriterëve islame apo jo, duhet të interesohet në veçanti për situatën përkatëse dhe të mos bazohet në informacione të përgjithshme.

1. Çfarë është leasing?

Leasing është një sistem financimi me dy kontrata të njëpasnjëshme, qira dhe shitje. Ndryshe quhet leasing financiar, kontratë leasingu financiar ose kontratë qiraje financiare. Në gjuhën arabe është quajtur kontratë qiraje që përfundon me pronësi.

Leasing është një metodë financimi afatmesme që bazohet në dhënien me qira, në kuadër të një kontrate qiraje, të makinave, pajisjeve, mjeteve të transportit dhe mallrave të tjera të luajtshme apo të paluajtshme, për sipërmarrësit që kanë nevojë për to; ndërsa në përfundim të afatit të qirasë, parashikohet shitja e tyre kundrejt një çmimi të përcaktuar paraprakisht.

Ky investim kryhet nëpërmjet një kompanie, zakonisht bankë ose shoqëri leasingu, në formën e mëposhtme:

E blen një pasuri (makinë, pajisje, makineri, pronë etj.),

la jep me qira klientit për një periudhë të caktuar,

Klienti paguan këste mujore,

Në fund të kontratës, zakonisht ka:

ose mundësi ta blejë pasurinë,

ose ta kthejë,

ose ta rinovojë kontratën.

Shembull

Ti dëshiron një makinë por nuk e paguan menjëherë. Kompania e leasingut e blen makinën dhe ta jep me përdorim. Ti paguan këste për 3-5 vite. Në fund, makina kalon në pronësinë tënde, nëse kontrata e parashikon këtë.

Sigurisht në përgjithësi leasing synon, që në fund, pronësia e artikullit të blerë paraprakisht nga kompania financuese, t'i kalojë klientit. Sepse qëllimi është të ndihmohet personat që nuk kanë mundësi financiare për ta blerë artikullin menjëherë.

Në thelb, veprimi i kryer këtu përbëhet nga shitja e mallit me këste, me shtyrjen e kalimit të pronësisë deri në përfundimin e kësteve, dhe më pas transferimi

i saj. Megjithatë, në bazë të kushteve është vlerësuar edhe shitje fillestare, ku kontrata e qirasë është vetëm në dukje e tillë, por në thelb është vetëm një trajtë e financimit të blerjes, si blerje me këste, porsia do të trajtohet më poshtë në pikën 2/b.

2. Situatat e kontratës leasing

Në bazë të llojit të kontratës, lindin disa situata të ndryshme. Disa shembuj janë si më poshtë vijon:

2.1. Dy kontrata të njëkohësishme

Leasing nuk lejohet nëse ka dy kontrata të njëkohësishme, pra s'mund të bëhen kontratë qiraje dhe shitjeje njëkohësisht, sepse këtë e ka ndaluar Profeti Muhamed (s.a.s.), duke thënë:

نَهَى رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنْ بَيْعَتَيْنِ فِي بَيْعَةٍ : صَفَقَةٌ وَاحِدَةٌ

"I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ndaloi dy shitje në një shitje – (pra) dy marrëveshje në një marrëveshje të vetme." Pra, thënë ndryshe, "Profeti (s.a.s.) ndaloi që në një transaksion të vetëm të përfshihen dy kontrata (dy marrëveshje) njëkohësisht."

Në këtë situatë, nëse leasing është një kontratë qiraje, që kushtëzon blerjen në fund, atëherë bëhet fjalë për dy kontrata në një trasaksion. Kjo është e ndaluar, sepse kjo kontratë është fasid (e pavlefshme).

2.2. Përfshirja e kamatës

Leasing nuk lejohet nëse në të gjendet kamatë. Sipas disa kontratave leasing, diferenca në çmimin e shitjes me leasing trajtohet si kamatë. Kjo e bën kontratën të ndaluar. Njëkohësisht, në disa raste të tjera, nëse klienti vonon këstet, atëherë bëhet fjalë për pagesë shtesë si ndëshkim për vonesën. Kjo gjithashtu është kamatë.

2.3. Dy kontrata të njëpasnjëshme

Leasing lejohet nëse ka dy kontrata të njëpasnjëshme. Pra, nëse është bërë një kontratë qiraje, e cila nuk kushtëzon blerjen, por në një moment të caktuar palët kanë të drejtë të mbyllin kontratën e qirasë dhe të bëjnë një kontratë të re, që mund të jetë shit-blerje.

2.4. Kontratë qiraje dhe hibe

Një kontratë qiraje që i mundëson qiramarrësit shfrytëzimin e sendit kundrejt qirasë së caktuar dhe për afat të caktuar, e shoqëruar me kontratë të veçantë dhurimi (hiba) të kushtëzuar me pagesën e plotë të qirasë; ose me premtim për dhurim pas pagesës së plotë

2.5. Kontratë qiraje me opSION blerjeje

Një kontratë qiraje ku pronari i jep qiramarrësit opsionin për ta blerë sendin me çmimin e tregut pas përfundimit të pagesës së të gjitha kësteve të qirasë.

2.6. Kontratë qiraje me premtim shitjeje

Një kontratë qiraje e shoqëruar me premtim për shitje të sendit pas pagesës së plotë të qirasë, me çmim të dakorduar nga palët.

2.7. Kontratë qiraje me të drejtë blerjeje

Një kontratë qiraje që i jep qiramarrësit të drejtën e

opsionit për ta fituar pronësinë në çdo kohë që dëshiron, me kusht që shitja të realizohet në atë moment me kontratë të re dhe me çmimin e tregut (ose sipas marrëveshjes së kohës).

2.8. Në dukje dy kontrata, në të vërtetë një kontratë Leasing lejohet nëse pavarësisht se duket sikur ka dy kontrata, në të vërtetë ka vetëm një kontratë dhe kjo dallohet nga kushtet. P.sh., pavarësisht se bëhet fjalë për një qiramarrës, në fakt ai ka të drejtat e një blerësi. Siç është që taksimi i shkon qiramarrësit dhe jo firmës që figuron si pronare. Apo fakti që nëse prona dëmtohet, atëherë përgjegjësia i mbetet qiramarrësit dhe jo firmës që figuron si pronare. Apo edhe mungesa e të drejtës së kompanisë për të mos e kaluar pronësinë në fund të kontratës së huasë. Në këtë rast pronari në letër është simbolik dhe praktikisht pronari real është klienti i kompanisë. Në të drejtën islame ka një parim ku thuhet:

العبرة في العقود للمقاصد والمعاني لا للألفاظ والمباني

"Në kontrata merret parasysh qëllimi dhe kuptimi, jo thjesht fjalët dhe forma e jashtme."

Prandaj konkludojmë se, pavarësisht se në pamje të parë kjo duket si një kontratë qiraje, në fakt është kontratë shitjeje.

Në këtë rast ka rëndësi që vlerat të cilësohen dhe të jenë fikse, në mënyrë që mos të bëhet fjalë për kamatë. Pra shuma totale e blerjes së klientit, vlera e kësteve mujore dhe numri i kësteve duhen përcaktuar që në krye.

3. Diferenca në çmim mes blerjes së menjëhershme dhe asaj me këste

Sipas të drejtës islame është e lejuar që çmimi mes blerjes së menjëherëshme dhe asaj me këste të ketë diferencë, me kusht që të ketë dakordësi midis palëve. Kjo është një kontratë, ku ka një propozim dhe një pranim. Shitësi është i lirë të përcaktojë çmime të ndryshme për forma të ndryshme pagese. Prandaj është mëse e natyrshe që blerja me këste të kushtojë më shumë. Ashtu siç është e lejuar dhe e natyrshe edhe e kundërta, ku ju ofrohet një çmim i caktuar për shitje me këste dhe një çmim më i ulët në rast të blerjes së menjëherëshme.

4. Përcaktimi i diferencës së çmimit sipas kursit të kamatës

Diferenca e çmimit të shitjes me këste në leasing mund të përcaktohet sipas indekseve të ndryshme financiare. Disa prej këtyre indekseve janë fikse dhe nuk ndryshojnë. Disa prej tyre janë të ndryshueshme. Marrja e kursit të kamatës si referencë për diferencën në çmime nuk përbën asnjë pengesë, sepse në këtë rast nuk bëhet fjalë për pagesë kamate, por vetëm për një kriter përcaktues të çmimit. Sidoqoftë, diferenca mes çmimit të blerjes së menjëherëshme dhe blerjes me këste do të ketë një diferencë, që do të përcaktohet në

bazë të një kursi. Në këtë rast është kursi i kamatës, por mund të ishte edhe kursi i euros apo dollarit.

Këshillohet me këmbëngulje, që të merren për referencë indekse të pandryshueshëm, sepse vetëm në këtë formë vlerat e pagesave mujore do të jenë të përcaktuara qartë.

5. Bashkëpunimi me bankat

Bashkëpunimi me bankat mbetet një problematikë permanente. Sepse banka punon me sistem kamate dhe kjo është e ndaluar rreptësisht në të drejtën islame. Por kjo është një çështje e ndarë nga vetë leasing, prandaj është një vendim i dytë, i cili nuk ndikon vetëm rastin në fjalë, por çfarëdojloj marrëdhënieje që ka myslimani me bankat.

Konkluzion

Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam, në sesionin e saj të dymbëdhjetë, mbajtur në Rijad, Mbretëria e Arabisë Saudite, në 25 Xhumada el-Ahira 1421H – 1 Rexheb 1421H (23–28 shtator 2000), duke e trajtuar leasing si dy kontrata të ndara, si në pikën 2.3 të lartpërmendur, ka arritur në konkluzionin se leasing lejohet nëse do të ekzistojnë dy kontrata të ndara, secila e pavarur nga tjetra në aspekt kohor, në mënyrë që kontrata e shitjes të lidhet pas kontratës së qirasë; ose të ketë një premtim për kalim pronësie në fund të periudhës së qirasë, qiraja të jetë reale dhe efektive, jo e maskuar për të fshehur një shitje.

Në këtë rast garancia do të mbetet mbi qiradhënësin. Prandaj, qiradhënësi mban përgjegjësi për çdo dëmtim që nuk vjen si pasojë e keqpërdorimit apo neglizhencës së qiramarrësit. Gjatë gjithë periudhës së qirasë zbatohen rregullat e qirasë; ndërsa në momentin e kalimit të pronësisë zbatohen rregullat e shitjes. Ndërkohë që shpenzimet e mirëmbajtjes jo-operative (strukturore/themelore) mbulohen nga qiradhënësi gjatë gjithë periudhës së qirasë.

Ngjashëm i është qasur edhe Këshilli për Çështje Fetare i Turqisë.

Në këtë rast mund të aplikohet një nga versionet e kontratave të parashtruata në pikat 2.3., 2.4., 2.5., 2.6., 2.7.

Ose plotësohen kushtet e një akti permanent shitjeje me këste, pavarësisht se në dukje aplikohet leasing si kontratë qiraje. Gjë që është trajtuar në pikën 2.8.

Së fundmi, mund të përmendim edhe faktin se disa dijetarë i janë qasur çështjes në këtë formë: Sidoqoftë sistemi leasing, nëse s'ka asnjë mënyrë tjetër për të kryer një blerje të domosdoshme, përveç kontratave me kamatë dhe leasing, më mirë është që të përzgjidhet kjo e fundit. /insi.al/



Të jetosh i lirë... deri ku?



Një nga ideologjitë që po përhapet gjithnjë e më shumë në shoqërinë e sotme është mendësia: “Unë kam jetën time dhe bëj me të çfarë të dua.”

Në pamje të parë, kjo ide mund të duket tërheqëse, por në thelb, nëse ndiqet pa kufij, ajo çon drejt zbrazëtisë, mëkatit dhe imoralitetit. Sot, shumë njerëz justifikojnë sjelljet si: imoraliteti, përdorimi i drogës, alkooli, sjelljet e shfrenuara, veshjet e papërshtatshme dhe mungesën e turpikësimit me këtë arsye: “Është jeta ime.”

Mirëpo, ekziston një parim thelbësor: që të quhesh njeri, duhet të jetosh si i tillë. Ndërsa jetesa njerëzore ka rregullat e saj morale dhe disiplinore.

Edhe në sistemin demokratik, që thekson të drejtat e njeriut, liria nuk është absolute. Ajo ka kufijtë e saj. Thuhet shpesh se liria jote përfundon aty ku fillon liria e tjetrit. Pra, askush nuk ka të drejtë ta përdorë lirinë e tij për të dëmtuar të tjerët.

Në këtë pikë, Islami nuk bie në kundërshtim me këtë parim. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran:

“Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!” (El-Kafirun, 6)

Kjo nënkupton se përderisa nuk çenohet liria, nuk ka armiqësi dhe ekziston respekt i ndërsjellë, atëherë bashkëjetesa është e mundur. Ky parim është zbatuar edhe në praktikë nga Profeti Muhamed (a.s.), i cili në Medinë e përfshiu këtë në marrëveshjen e njohur si “Karta e Medinës”.

Allahu i ka krijuar njerëzit të ndryshëm dhe ka dashur që ata të jenë të tillë. Në Kuran thuhet:

“Sikur të kishte dashur Allahu, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm...” (En-Nahl, 93)

Kjo tregon se njeriu është i lirë në zgjedhje. Atij i është dhënë mendja, dëgjimi dhe shikimi për të dalluar të vërtetën nga e pavërteta. Ai është i lirë të besojë ose jo, të bëjë mirë ose keq.

Allahu thotë:

“Ne i treguam atij rrugën: ose do të jetë mirënjohës, ose mohues.” (El-Insan, 3)

Nëse jeta shihet vetëm nga perspektiva e kësaj bote, atëherë duket sikur njeriu mund të bëjë çfarë të dojë. Por problemi qëndron pikërisht këtu: shumë njerëz mendojnë vetëm për një jetë që përfundon me vdekjen.

Për ta, vdekja është fundi. Prandaj filozofia e tyre bëhet: “Ta jetojmë jetën si të vijë, sepse vetëm një herë jetojmë.” Kjo është fatkeqësia më e madhe: mosnjohja e Zotit dhe e qëllimit të vërtetë të jetës.

Edhe besimtari ka liri veprimi, por atë e kufizon vetëdija dhe njohja e Zotit. Për të, vdekja nuk është fundi, por fillimi i jetës së vërtetë. Prandaj thuhet se njeriu është si në gjumë, dhe kur vdes, zgjohet.

Allahu pyet në Kuran:

“A mendon njeriu se do të lihet pa përgjegjësi?” (El-Kijame, 36)

Kjo pyetje duhet ta zgjojë ndërgjegjen e çdo njeriu:

Si erdha në këtë botë? Pse erdha? Cili është qëllimi im? Ku po shkoj?

Kur njeriu reflekton mbi këto pyetje, ai fillon kërkimin e së vërtetës dhe njohjen e Krijuesit të tij.

Allahu e përshkruan krijimin e njeriut si një mrekulli: **“A nuk ka qenë ai në një pikë uji që derdhet.**

E pastaj u bë gjak i trashë, e Ai e krijoi dhe e përsosi?

Dhe prej tij Ai i bëri dy lloje: mashkullin dhe femrën.

A nuk është Ai (Zot) i Fuqishëm, që i ngjall të vdekurit? (El-Kijame, 37–40)

Kjo na tregon se Ai që krijoi njeriun nga asgjëja, ka fuqinë ta ringjallë atë.

Besimtari jeton me këtë vetëdije: ai mendon për jetën tjetër dhe për ditën kur do të dalë para Allahut. Kur e kupton madhësinë dhe fuqinë e Tij, ai e orienton jetën drejt asaj që e kënaq Zotin, jo drejt asaj që e hidhëron Atë. Prandaj, shumë nga devijimet në shoqëri vijnë si pasojë e mungesës së besimit dhe mosnjohjes të së vërtetës.

Pas sqarimit të së vërtetës, nëse njeriu zgjedh të vazhdojë në rrugën e gabuar, atëherë zbatohet fjala e Profetit Muhamed (a.s.):

“Nëse nuk ke turp, bëj çfarë të duash.” (Buhariu)

Ndërsa Allahu thotë:

“Nuk ka detyrim në fe. E drejta është dalluar qartë nga e shtrembra...” (El-Bekare, 256)

Në fund, i lutemi Allahut të na ruajë nga e keqja dhe të na udhëzojë në rrugën e drejtë.

Amin.

BUJQËSIA, XHIHADI DHE SHPËTIMI YNË



“Kur të merreni me tregti ‘ine, të kapeni pas bishtave të lopëve, t’ia kushtoni jetën bujqësisë dhe të braktisni xhihadin (përpjekjen për ti shërbyer fesë), Allahu do t’ju japë një poshtërim të tillë sa nuk do të mund ta largoni, derisa të ktheheni sërish në fenë tuaj.”

(Ebu Daudi, Buju’, 54; Ahmed ibn Hanbeli, Musned, 2/42, 84)

Besimtari do të fitojë dinjitet dhe fisnikërinë e tij përmes përpjekjes së shenjtë që zhvillon brenda vetes dhe jashtë saj. Mirëpo, kur ai nuk e përmbush detyrën që i takon, kur apasionohet me jetën dhe gjërat e kësaj bote dhe kur mbetet i lidhur pas kënaqësive personale, atëherë edhe nderi dhe dinjiteti i tij do të zhduken, dhe ai do të përfundojë i mjerë dhe i shkatërruar. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi qofshin mbi të) ka thënë: *“Kur një shoqëri e braktis xhihadin (përpjekjen për ti shërbyer fesë), Allahu i Madhëruar u jep një dënim të përgjithshëm dhe fatkeqësi kolektive.”* Prandaj, të jetosh me dinjitet është e mundur vetëm duke përballuar disa vështirësi në emër të fesë. Një shoqëri, vetëm duke u përballur me kësaj vështirësi në mënyrë kolektive e fiton të drejtën për të jetuar me nder dhe fisnikëri. Mirëpo, nëse individët, një e nga një, e braktisin përpjekjen për fenë vetëm për të jetuar jetën e tyre personale, atëherë vjen dënimi i përgjithshëm i Allahut dhe ai e godet shoqërinë pa dallim, duke përfshirë si të pafajshmin e agresorin, ashtu edhe shtypësin e të shtypurin. Prandaj, për të mos u ekspozuar ndaj një fatkeqësie kolektive të kësaj

natyre, është e domosdoshme që shoqëria t’i përfaqëtoj detyrat e fesë në mënyrë të përbashkët.

Çështja e parë e përmendur në hadith është **“tregtia ‘ine”**. Kjo lloj tregtie shpjgohet në dy forma. E para: një person blen një mall me pagesë të vonuar dhe më pas ia shet po të njëjtit person të njëjtin mall me çmim më të ulët dhe me pagesë të menjëhershme. Qëllimi i kësaj është ky: personi ka nevojë për para dhe, meqë marrja e drejtpërdrejtë e parave dhe kthimi i tyre me tepricë do të përbente kamatë, ai i drejtohet një rruge të tillë. Zbatimi praktik i kësaj është si vijon: të supozojmë se dikujt i nevojiten 80 mijë lekë; ai blen me pagesë të vonuar një mall që i përket dikujt tjetër për 100 mijë lekë. Më pas, të njëjtin mall ia shet po atij personi për 80 mijë lekë me pagesë të menjëhershme. Një veprim i tillë, që nga jashtë duket si tregti normale, nuk ka asnjë dallim nga kamata dhe në mënyrë absolute nuk është i lejuar.

Shpjegimi i dytë i tregtisë “ine” është ky: ajo nënkupton zbatimin e diferencës së afatit. Për shembull, një borxhli vjen dhe thotë se nuk është në gjendje ta shlyejë borxhin e muajit. Menjëherë, duke llogaritur kohën e shtyrjes dhe shumën e borxhit, mbi të ngarkohet një diferencë afati. Të dyja këto praktika, nga këndvështrimi Islam, nuk janë të sakta.

I Dërguari i Allahut, në këto hadithe fisnike, vë theksin mbi imoralitetin që kryhet ndër njerëz, në emër të tregtisë dhe marrëdhënieve ekonomike, nga fshatrat deri në qytetet më të mëdha, nga vendet më të largëta

deri në qendrat më të zhvilluara, dhe paralajmëron se, kur ky imoralitet ju vë nën robërinë e tij, atëherë duhet të prisni poshtërimin.

Sa i përket çështjes së dytë të përmendur në hadith, shprehja "kur kapeni pas bishtave të lopëve dhe harroni çdo gjë tjetër përveç bujqësisë" nuk e ka kritikën ndaj vetë bujqësisë. Kjo sepse i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Edhe nëse po shpërthen Kiameti, nëse keni në dorë një fidan, mbillenit atë." Për më tepër, Islami nuk e toleron amullinë dhe pasivitetin. Ajo që kritikohet këtu është mungesa e ekuilibrit, sepse nëse prodhimi – që përbën boshtin jetik të jetës ekonomike – reduktohet vetëm në bujqësi dhe tregtia e industria neglizhohen, atëherë kemi të bëjmë me një çekuilibër ekonomik. Po kështu, edhe zhvillimi i njëanshëm i fokusuar vetëm në tregti ose vetëm në industri përfaqëson një tjetër formë të po këtij çekuilibri. Prandaj, thelbësore është t'i jepet çdo sektori vlera e duhur dhe të sigurohet një balancë e shëndoshë e prodhimit.

Bujqësia zhvillohet në fshatra; për rrjedhojë, përkushtimi i plotë i shoqërisë vetëm ndaj bujqësisë nënkupton ndalimin e plotë të urbanizimit. Ndërprerja e urbanizimit do të thotë shuarje e industrisë dhe e tregtisë. Nga ana tjetër, braktisja masive e fshatrave dhe dyndja drejt qyteteve të mëdha do të prodhonte probleme të tjera serioze. Rritja e shpejtë e qyteteve, ashtu siç ndodh sot, do të sillte probleme të reja në përpjesëtim me ritmin e rritjes, do të paralizonte shërbimet nëntokësore dhe mbitorësore dhe do ta çonte papunësinë në nivele alarmante.

Nëse zhvillimi nuk është i balancuar dhe një pjesë e jetës ekonomike mbetet e varur nga jashtë, duhet pasur gjithmonë parasysh se goditjet nga ajo anë janë të pashmangshme. Industria e varur nga jashtë, ashtu si edhe tregtia apo produktet bujqësore të varura nga jashtë, përbëjnë kërcënim për stabilitetin ekonomik. Prandaj, parimi themelor është ruajtja e ekuilibrit në të gjitha fushat.

Në kohën e të Dërguarit të Allahut ﷺ nuk ekzistonte problemi i urbanizimit të shpejtë, për këtë arsye, çekuilibri ekonomik në hadith është shprehur si përkushtim i tepruar vetëm ndaj bujqësisë. Sot, përkundrazi, urbanizimi i shpejtë dhe problemet që ai sjell përbëjnë një tjetër shenjë të qartë të çekuilibrit. Në këtë kuadër, çështja e rikthimit në fshat ose e vendosjes së qëndrueshme në zonat rurale është një temë që duhet trajtuar seriozisht, dhe këtë kuptim është e mundur ta nxjerrim edhe nga hadithi.

Nga ana tjetër, kthimi pas në beduinizëm (primitivitet) pas arritjes së qytetërimit, ose këmbëngulja në një mënyrë jetese primitive, është po ashtu një dukuri e kritikuar në hadith. Të gjitha këto çojnë në poshtërim dhe mjerim.

Çështja e tretë e përmendur në hadith është kjo: "Kur hiqet dorë nga xhihadi (përpjekja për ti shërbyer fesë),"

kurnjeriu zhytet në rehati, mbyllet në interesat personale dhe mbytet në to, atëherë mbi të rëndon poshtërimi. Në këto kushte, ashtu siç errësohet atmosfera materiale, errësohet edhe jeta e juaj shpirtërore. Yjet e qiellit të shpirtit bien, hëna dhe dielli pësojnë eklips dhe në një gjendje të tillë, jeta juaj në tokë nuk është më e denjë për tu jetuar. Derisa të realizohet një kthim i vërtetë tek feja, sado të luten dhe të përgjërohen njerëzit, Allahu nuk do ta largojë prej tyre këtë gjendje poshtërimi.

Por si do të jetë i mundur kthimi tek feja? Mbi supet tona rëndojnë detyrime të grumbulluara ndër shekuj. Ne nuk kemi arritur të përmbushim as detyrimet tona ndaj vetvetes, e lëre më ndaj familjes, shoqërisë dhe brezave që vijnë. Mbi shpatullat tona të brishta janë ngarkuar shumë përgjegjësi morale. Myslimani i ndërgjegjshëm i shekullit të njëzetë është i përkulur nën këtë barrë, dhe çështja është jashtëzakonisht e vështirë, sepse përballemi me klithmën e një shembjeje tre shekullore. Pa kaluar një periudhë të gjatë dhimbjeje dhe përpjekjeje, kjo klithmë nuk mund të shuhet. Megjithatë, përgjegjësia për këtë gjendje na takon vetë neve dhe po ashtu, shpëtimi do të vijë vetëm përmes nesh. Duhet të shtrëngojmë dhëmbët, të ndezim vetë pishtarin tonë, t'i drejtohem Allahut dhe këtë drejtim ta shfaqim si me fjalë, ashtu edhe me vepra. Vetëm atëherë dyert e Mëshirës do të na hapen dhe dora e Mëshirës do të na nxjerrë nga kjo gjendje drejt bregut të shpëtimit.

I Dërguari i Allahut ﷺ përballej me gjithë botën, me një bashkësi të vogël njerëzish të tillë, ku çdo individ e dinte qartë se çfarë përgjegjësie i takonte në cilën pjesë të jetës. Për ta, një jetë pa xhihad (përpjekje për ti shërbyer fesë) ishte një jetë e humbur. Fjalët e tij në këtë drejtim janë vërtet domethënëse, ku thotë: "Nëse një njeri vdes pa kryer asnjë xhihad (përpjekje për ti shërbyer fesë) dhe pa treguar asnjë përpjekje në këtë drejtim, ai ka vdekur brenda një dege të hipokrizisë dhe e ka dorëzuar shpirtin në një terren nifaku (hipokrizie)."

Ndërsa në një transmetim tjetër thotë: "Nëse një njeri paraqitet para Allahut pa asnjë gjurmë xhihadi (përpjekjeje për ti shërbyer fesë) në jetën e tij, kjo do të thotë se është paraqitur me një boshllëk serioz."

Kjo do të thotë se ai njeri do të dalë para Mahkeme-i Kubra'së (Gjykimit të Madh) me një mangësi që do ta turpërojë.

Rreth nesh ka njerëz që copëtohen, dhunohen dhe rënkojnë nga dhimbja. T'u dalësh në ndihmë të shtypurve është detyrë po aq sa është detyrë t'i kundërvihesh padrejtësisë së shtypësit. Përndryshe, para Zotit të botëve do të shkojmë me një simfoni të dhimbshme, ku refreni i saj do të jetë psherëtimja e të shtypurve, klithmat e grave të dhunuara dhe rënkimet e jetimëve. Të ringjallesh përpara Zotit me këtë mangësi e faj është një fatkeqësi e jashtëzakonshme!..

RËNDËSIA DHE QËLLIMI *i Haxhit*



Haxhi është obligimi i pestë themelor i myslimanëve dhe paraqet ngjarje të adhurimit të Allahut, si dhe ngjarje e kontratave dhe tubimeve të myslimanëve. Për këtë atij i është dhënë dhe i është kushtuar kujdes i veçantë dhe gjithmonë ka qenë preokupim kryesor i atyre të cilët e kanë pasur për obligim të vizitojnë shtëpinë e Allahut-Qaben dhe të falen në të, të shohin xhaminë e Pejgamberit (a.s.), të vizitojnë Bedrin, Arafatin, Minën, etj., duke i përkujtuar momentet më të vështira të Profetit (a.s.) gjatë kryerjes së misionit të Allahut (xh.sh.).

Të flasësh për rëndësinë e vizitës së Haxhit nuk është lehtë për arsye se çdo detyrë apo obligim islam jep ide të shumta dhe njeriu merr prej tyre aq sa është në gjendje të thellohet në domethënien e tyre. Ne do do të mundohemi të përkufizohemi vetëm në disa nga porositë dhe qëllimet e Haxhit.

Haxhi pikërisht vërteton përvullësinë e besimtarëve dhe nënshtrimitin e tyre ndaj urdhrave të Allahut si dhe vërteton vendosmërinë e tyre për të qenë robë dhe të adhurojnë vetëm Allahun, dhe se kurrsesi robër të interesave dhe të mirave materiale. Pra, qëllimi kryesor i Haxhit është adhurimi i singertë i Allahut - ibadeti.

Në të njëjtën kohë haxhi paraqet kongresin më të madh vjetor gjithislam, i cili mundëson njohjen reciproke të besimtarëve, mundëson shfrytëzimin e përvojave dhe analizimin e nevojave të përbashkëta, etj. Pra, ai është takim ku besimtarët duhet të ndërrojnë mendime, përvoja dhe dituri të ndryshme me qëllim të dhënies së kontributit më të madh në të gjitha sferat e humanizmit të përgjithshëm njerëzor.

Haxhi, po ashtu paraqet tubimin më të madh dhe më të rregullt botëror mbi mirëqenien njerëzore. Gjatë kryerjes së këtij obligimi fetar, në çdo lëvizje, në çdo hap dhe ritual duhet të dominojë paqja dhe mëshira. Këtë e kuptojmë nga fjalët e Allahut xh.sh., kur thotë:

“Haxhi është në muaj të caktuar. Ai që është i detyruar ta kryejë Haxhin në atë muaj nuk duhet të ketë kontakt me gra, as të flet fjalë të këqija...”(Bekare, 197)

Pra, ai është tubim ku mbizotëron paqja me Krijuesin, paqja me pjesmarrësit në rituale, paqja me shtazët, paqja me shpezët

dhe insektet. Në këtë vend dhe gjatë kësaj kohe nuk guxon të shqetësohet askush, bile nuk guxon askush të shikohet shtrembër, e as t'i bëhet dikujt ndonjë sulm fizik apo dëm tjetër.

Kryerja e Haxhit paraqet demonstrim të universalitetit islam, demonstrim i vëllazërisë dhe barabarësisë në mes të myslimanëve. Gjatë gjithë kohës së Haxhit gjenden të tubuar i bardhi, i ziu, i kuqi, i verdhi të veshur me veshje të njëjtë të çliruar nga epitetet kryetar, sundues, pasanik, mbret, rob, i varfër, i padijshëm, etj. Të gjithë janë të barabartë sikur kokrat e rërës në shkretëtirë. Gjatë asaj kohe mbretëron përvullësia, devotshmëria dhe afrimi tek Allahu. Vetëm këtu në këtë vend të bekuar mund të shihet se besimtarët nga të gjitha vendet e botës, në mënyrë vëllazërore shtrëngojnë duart njëri me tjetrin dhe me lot ndër sy nga gëzimi i madh përqafohen të vetëdijshëm se janë në vendin e bekuar, aty ku egoizmi dhe interesi material i kësaj bote nuk kanë vend dhe ndikim, aty ku flet ndërgjegja e pastër, zemra e pastër dhe morali i pastër.

Këtu në këtë vend të bekuar, në të menduarit e çdo vizitori të Qabes i përkujtohen fjalët e Muhamedit(a.s.), i cili në Haxhin e fundit të tij, para 14 shekujsh, për herë të fundit i apeloj njerëzimit me fjalimin e tij të famshëm, ku mes të tjerash tha:

“O besimdrejtë!...ju të gjithë jeni plotësisht të barabartë në të drejta dhe obligime! Kurrfarë përparësie nuk ka në mes të arabit dhe joarabit, as në mes të bardhit dhe të ziut. Të gjithë ju jeni bijtë e Ademit, dhe Ademi është prej toke! Ruajeni dhe çmojeni personalitetin e njeriut dhe dinjitetin e tij! Njeriu është vepër madhështore e Allahut dhe mjerë për atë që e rrënon nderin e veprës së Allahut xh.sh.... Mbaroi periudha e paditurisë dhe traditave të zymta të cilat aq shumë të këqija i sollën gjinisë njerëzore... Gjakmarja është e ndaluar...”

Pra, siç shihet, haxhi në realitet është aksion dhe aktivitet i pandërprerë shpirtëror, i cili përmban ide të ndryshme të cilat janë mjaft nxitëse në aktivitetin progresiv dhe human të çdo besimtari, pse ai, sikur u përmend më lart, paraqet konsultim gjithë islam dhe simbolizon unitetin e plotë shpirtëror të të gjithë pjesëtarëve të besimit islam.

SAKRIFICA E KURBANIT PËRKUJDESJE NDAJ NJERIUT

Festa e Kurban Bajramit është festë me rëndësi të veçantë për arsye se në ditët e kësaj feste çdo besimtar i pasur sakrifikon një pjesë të pasurisë për hir të Allahut, sakrificë kjo që manifestohet nëpërmes prerjes së kurbaneve dhe në këtë mënyrë e gjithë kjo është ndër principet dhe vlerat më të larta etike të Islamit, për arsye se sipas Islamit nuk ka vepër të mirë, të madhe dhe të dobishme pa sakrificë të madhe. Ajo mund të manifestohet nëpërmjet formave të ndryshme, sikurse, në formë të sakrifikimit të pasurisë, në formë të largimit nga diçkaje si dhe nëpërmjet të vepruarit dhe të aktivizuarit fiziko-mendor. Islami, pra, duke pasur për qëllim formimin e individëve dhe bashkësisë së shëndoshë këtë princip të përgjithshëm etik e bëri bazë në jetën e çdo besimtari. Kështu që, përveç sakrificave mendore, fizike, etj., e bëri obligim sakrifikimin e një pjese të pasurisë për hir të Allahut, për arsye se, sipas mesimit Islam, ajo që është më e vlefshme dhe më humane nuk mund të arrihet pa u sakrifikuar ajo që është më e vlefshme dhe më e dashur. Ndër këto sakrifica është edhe institucioni i Kurbanit, i cili përbëhet nga prerja e kafshës së caktuar në emër të Allahut në kohë të caktuar.

Qëllimi dhe rëndësia kryesore e çdo dispozite islame është devotshmëria, gjegjësisht, pasurimi me vlera të larta, humanizimi dhe përsosshmëria e njeriut, kujdesi për njeriun që ai të mos e humbë pozitën e dhuruar nga Allahu. Pra, edhe institucioni i Kurbanit ka rëndësi dhe vlerë të madhe në formimin e personalitetit të njeriut dhe bashkësisë.

Kurbanit theret për hir të Allahut. Me këtë akt besimtari mundohet të arrijë shkallën më të lartë të përsosshmërisë, e cila në mesimin Islam quhet "Et-tekva" që do të thotë: "devotshmëri", "respekt i jashtëzakonshëm ndaj Allahut" "nënshtrim i plotë i urdhrave të Allahut"; që do të thotë se njeriu përmes Kurbanit vërteton qëllimin kryesor të jetës së tij, e ai qëllim është njohja e Krijuesit - Allahut dhe të jetuarit sipas urdhrave të Tij, ndërsa në anën tjetër vërteton se të gjitha të mirat materiale dhe begatitë e tjera nuk janë qëllim të jetës por vetëm mjete për të jetuar dhe njohur Allahun.

Në të njëjtën kohë, me anë të kurbanit besimtari e falënderon Allahun për të gjitha të mirat që ia ka dhënë Ai në shfrytëzim. Nga kjo del si përfundim se njeriu nuk punon për të ngrënë, por han për të jetuar.

Këtë më së miri e shohim nga rrëfimi Kur'anor mbi Ibrahimin (a.s.), i cili u urdhërua nga Krijuesi i vet, që për hir të Tij të sakrifikojë atë që është më e shtrenjtë, të birin - Ismailin, sakrificë të cilën, më në fund Allahu e zëvendësoi me një dash. Ja se si e përshkruan Kur'ani Famëlartë këtë

ngjarje:

"O Zot, më dhuro pasardhës prej të mirëve! Dhe ne e gëzuam me një djalosh të mirë. Kur ai u rrit aq sa filloi të ecë me të në punë, Ibrahim tha: O biri im, kam parë një ëndër se duhet të të ther! Pa shiko ç'mendon ti." Ai iu përgjigj: O babai im! Ti vepro ashtu si të urdhërohet. Do të jem në dashtë Allahu prej durimtarëve." Dhe kur ata të dy u dorëzuan edhe e shtriu atë me fytyrë në tokë, Ne thirëm: O Ibrahim ! Ti e realizove ëndrën. Ne kështu i shpërblejmë ata që bëjnë vepra të mira. Ajo ishte njëmend sprovë vërtetë e qartë, dhe e shpërblyem me një Kurban të madh." (Saffat, 102-107)

Kjo sprovë e Ibrahimit (a.s.) ka qenë e pashembullt në historinë e gjinisë njerëzore. Gatishmëria e Ibrahimit të sakrifikojë gjënë më të shtrenjtë - djalin si dhe gatishmëria e Ismailit të sakrifikohet, është porosi e cila vërteton se jeta e çdo individit deri në fund duhet të jetë në përputhje me dëshirën dhe vullnetin e Allahut. Këtu qëndron mbështetja historike, kuptimi dhe domethënia e Kurbanit në Islam, me anë të cilit njeriu përsoset pandërprerë duke u çliruar nga egoizmi si dhe ndjenjat e tjera shtazarake

Kurbanit, në të njëjtën kohë, është ngritje në shkallën më të lartë të përsosshmërisë shpirtërore, në shkallën më të lartë të vullnetit të vendosur i cili çliron nga çdo gjë që pengon vendosshmërinë e cila përgatit njeriun të sakrifikojë për atë që është e mirë dhe humane: mundin, kohën, pasurinë, e më në fund edhe vetveten, sikur që vepruan Ibrahim dhe Ismaili (a.s.).

Porosia më kryesore e praktikës së Kurbanit është afirmimi dhe forcimi i elementit njerëzor në qenien e besimtarit, që do të thotë se Kurbanit paraqet betejën mjaft të rëndësishme në afirmimin e njeriut. Kur Ibrahimit (a.s.) në vend të djalit iu dhurua dashi për sakrificë në këtë moment filloi dhe vazhdoi procesi për çlirimin e njeriut, për dallimin e tij nga kafsha, gjegjësisht rivendosjen e tij në pozitën e caktuar nga ana e Allahut, e kjo do të thotë mbrojtja e dinjitetit të njeriut. Caktimi i dashit në vend të njeriut - Ismailit qartësoi se lufta më kryesore dhe më e rëndësishme është lufta për afirmimin e humanizmit njerëzor, gjegjësisht lufta për afirmimin e vlerave më të larta njerëzore, sepse njeriu është vepra më madhështore e Allahut.

Jemi dëshmitarë të kohës në të cilën jetojmë, ku njeriu ka arritur rezultate të mëdha dhe ka bërë hapa gjigantë në fushën shkencore, në mënyrë fantastike ka zbuluar dhe ka "pushtuar" natyrën, është ngritur në qiejt më të lartë, mirëpo në fushën tjetër e cila është shumë primare ka ngecur shumë prapa: ajo është kujdesi për njeriun dhe vlerat e

larta humane. Është fakt se njeriu në fushën shkencore po përparon, mirëpo nga ana tjetër ka harruar vetveten, kështu që shkencat humane ende nuk janë në gjendje të definojnë njeriun dhe të japin zgjidhje për problemet e tij.

Kjo ndodhi për shkak se një pjesë e njerëzve kah gjysma e shekullit XIX e deri në kohën e fundit duke u mbështetur në të menduarit jo të shëndoshë mendoi se u bë i plotëfuqishëm dhe duke u larguar nga Zoti u mundua të imponojë mendimin se njeriu për ta siguruar ardhmërinë e tij duhet si e si t'i largohet fesë, për arsye se feja, gjegjësisht besimi në Zot është "rezultat i paditurisë", "shprehje e varfërisë së vërtetë ose protestë kundër varfërisë së vërtetë", "opium i popullit", "psherëtimë e krijesës së nënshtruar", "shpirt i botës pa zemër", "vetëdije ose vetëndjenjë e njeriut i cili vetveten ose nuk e ka gjetur ose e ka rihumbur", "vetëdije e shkatëruar mbi botën", "iluzion", "produkt i kushteve shoqërore", etj. Për këtë arsye, njeriu, sipas tyre, duhet të jetojë pa Zot dhe jashtë ligjeve të Tij.

Pjesa tjetër e botës afërmoi idenë se Zoti duhet të besohet, por nuk ka nevojë të jetojë sipas urdhrave të Tij, sepse njeriu përmes zbulimeve që bën është në gjendje ta zgjedhë vetë jetën e vet, i lirë ngaqë i bën është në gjendje vetë ta zgjedhë jetën e vet, i lirë nga çdo përgjegjësi tjetër. Njeriu për të siguruar jetën e vet materiale u dha në aksion, aksion e cili e dërgoi në vetëharresë. Pasurimi material botën dhe njeriun e bëri çdo ditë edhe më tepër jo të sigurtë, kështu që sot njeriu modern është i barabartë me rekrutin, të cilin nuk e lënë të qetë, i cili është i detyruar që patjetër të bëjë diçka. Në këtë mënyrë kujdesi i njeriut të sotshëm është i drejtuar gjithmonë në atë që është e jashtëm, sekondare, ndërsa për atë që është primare, njerëzore shumë pak ose aspak nuk mendon, për arsye se ai është bërë rob i interesave vetjake. Kjo ndodhi edhe për shkak se njeriu në vend të fesë – Zotit, si udhëheqës mori shkencën, e cila pa fe është e verbër, e çalë.

E gjithë kjo e solli botën në një pasiguri totale. Në atë pjesë ku botës iu imponua mosbesimi, në vend të Zotit të vërtetë u zgjodh zoti –njeri, ndërsa në pjesën tjetër u zgjodh për Zot epshi, interesi material i cili duhet të diktojë marrëdhëniet ndërmjet popujve në botë.

Prandaj nuk duhet të habitemi kur sot dëgjojmë dhe lexojmë, se në vendet më të zhvilluara ekonomikisht, me të madhe po përhapet alkoolizmi, narkomania, prostitucioni, sadizmi, mazogizmi, homoseksualizmi, lezbizmi, etj.

Në anën tjetër është zbehur kujdesi për njeriun ku me të madhe shkelet e nënçmohet nderi i tij. Miliona fëmijë, burra, gra vdesin nga uria. Po ashtu hasim në popuj të cilët nuk kanë të drejtë të jetojnë, nuk kanë të drejtë t'i gëzojnë të drejtat e tyre fetare, kombëtare, ekonomike, sociale, etj. Ndërsa bota tjetër "përparimtare" dhe e "zhvilluar" sot i jep vetes të drejtë që nën thundrat e tyre të mbajnë gjysmën e botës duke prekur në të drejtat dhe nderin e tyre. Çdo ditë më shumë po dëgjojmë, krime të tmershme, vrasje me të cilat bota më është mësuar dhe i janë bërë shprehi. Sot në botën "përparimtare" vdekja është bërë shprehi – pjesë

harxhuese. Vrasja është bërë aksion. E gjithë kjo na tregon se kujdesi për njeriun plotësisht ka rënë. E gjithë kjo është rezultat i largimit të njeriut nga Zoti si dhe nga të jetuarit sipas urdhrave të Tij.

Njeriu njëherë e përgjithmonë duhet ta kuptojë se është krijesa më madhështore e Allahut dhe se thellë brenda tij është rrënjosur nevoja për të besuar, dhe për këtë kjo nevojë duhet të zhvillohet me qëllim të lumturisë së njerëzimit në këtë dhe botën tjetër. Feja është ajo që i kënaq nevojat individuale dhe kolektive, për arsye se, siç thotë Emile Dyrkemi, "shkenca është fragmentare dhe jo komplete; ajo përparon, mirëpo ngadalë dhe asnjëherë nuk kryhet; mirëpo jeta nuk pret. Shkenca është shpjegim shkencor i sendeve, ndërsa feja është ajo që çdo gjëje i jep vlerë dhe qëllim".

Sa më tepër që i kthehem Zotit-fesë aq më tepër do ta çmojmë vetveten dhe njeriun dhe aq më tepër do ta ndjejmë nevojën për kujdesin ndaj njeriut, për arsye se çdo princip apo urdhër fetar është zbritur vetëm për shkak të njeriut, që ai në to të gjejë vetveten dhe të jetojë i lumtur në këtë dhe botën tjetër.

Pra, edhe institucioni i Kurbanit si praktikë fetare ka rëndësi të madhe për jetën e njeriut. Përveç që është praktikë adhurimore, ai ka rëndësi të madhe edhe për nga aspekti social, ku përsëri vjen në shprehje kujdesi për njeriun, që do të thotë se mishi i Kurbanit duhet të jepet tek ata të cilët janë të varfër. Muhamedi (a.s.) porosiste që mishi i Kurbanit të ndahet në tri pjesë: një pjesë t'u jepet të varfërve, një pjesë të afërmve, fqinjëve dhe miqve, ndërsa pjesa e tretë të mbahet për vete. Vetë ai mishin e Kurbanit ia ndante të varfërve dhe u thoshte: "Kujt i duhet le të presë aq sa dëshiron!"

Njëherë Muhamedi a.s. duke ukthyer në shtëpi e pyeti Aishen r.a. se çka u bë me delen e prerë, ajo i tha: "Të gjithën e kemi ndarë përveç shpatullës!" Pejgamberi (a.s.) i tha: "Jo, e gjitha ka mbetur përveç shpatullës".



Pesë dhunti

"Atje, ata do të thërrasin: "O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë." (Atyre do t'u thuhet): "Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijoni (dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!" (Fatir, 35/37)

Profeti a.s. ka thënë: "Dijani vlerën pesë dhuntive të Allahut përpara se vendin e tyre ta zënë pesë të tjera: Vlerën e shëndetit përpara se të vijë sëmundja, rinisë përpara se të vijë pleqëria, pasurisë përpara se të vijë varfëria, kohës së lirë përpara se ajo të zihet, jetës përpara vdekjes." (Bejhakî, Shuabul Imân, Nr. 9575)

Profeti Muhamed a.s., i cili i ka treguar rrugët e shpëtimit dhe të suksesit mbarë njerëzimit në çdo fushë të jetës, kërkon dhe fton besimtarët që në pesë dhunti të Allahut të dalin përsëri fitues.

Këto pesë dhurata të Allahut i janë dhënë çdokujt prej nesh dhe nëse ka një mirësi prej tij kjo shton edhe përgjegjësinë. Secila prej tyre i është dhënë njeriut për qëllime të caktuara dhe është e domosdoshme të shfrytëzohen në ato drejtime.

Vjen një ditë dhe shëndetin e zë sëmundja, kohën e lirë e zënë punë të cilat as që nuk e dimë se nga kanë dalë. "Ka dy dhunti të Allahut në të cilat shumë prej njerëzve janë në humbje: shëndeti dhe koha e lirë". Këto janë dy thesare shumë të çmuar, të cilët kur humben, nuk kthehen më

mbrapsht. Hapi i parë për t'i shfrytëzuar siç duhet është që të jemi të ndërgjegjshëm për vlerën e tyre.

Rinia është një mundësi e artë për çdokënd që e jeton atë. Të jemi realistë e të mendojmë. Përpara periudhës së rinisë gjendet fëmijëria. Në këtë moshë njeriu nuk e ndan dot të mirën nga e keqja, prandaj edhe fetarisht nuk është përgjegjës për çka vepron. Pas rinisë vjen pleqëria. Çdo moshë e njeriut ka vlerën e saj dhe pleqëria karakterizohet nga eksperiencia dhe maturaia. Profeti a.s. shprehet: "Po të mos ishte për të moshuarit mes jush, atëherë do t'ju pushtonin problemet dhe sprovat". Por ja që atëherë njeriu nuk e ka më gjallërinë fizike dhe fuqinë e dikurshme. Nisur nga ky fakt, në një fjalë të urtë thuhet: "Ah sikur për një moment të kthehesha në rini dhe t'i tregoja asaj se ç'më ka bërë pleqëria"; sepse s'do të kemi mundësi që të bëjmë gjithçka që duam.

Allahu i Madhëruar në një hadith kudsî shprehet kështu për të rinjtë: "Të rinjtë që kryejnë adhurimet dhe jetojnë me vetëdijen se janë rob të Zotit, kanë vlerën e disa engjëjve të veçantë pranë Meje". E si të ishte ndryshe kur ndërkohë që shumë persona rininë e tyre e kalojnë mes dëfrimesh e duke rendur pas kërkesave trupore, disa të tjerë, pavarësisht orientimit të nefsit, ruajnë qëndrueshmërinë, stoikë përballë çdo kërkesë negative. Për të tillë persona Allahu ka shpërblime të veçanta, njëren ndër të cilat Profeti a.s. e shpreh kështu: Ndërkohë që të tjerët do të japin me shumë vështirësi llogarinë në Ditën e Kiametit,



një ndër grupet që do ta kalojnë më lehtë këtë etapë të rëndësishme janë rioshët që kanë kryer adhurimet dhe kanë jetuar me vetëdijen e ekzistencës së Allahut, duke qëndruar larg mëkateve.

Lypja është qortuar nga feja dhe i është kushtuar shumë rëndësi punës. Madje të punosh që të fitosh për veten dhe familjen në mënyrë që mos t'i bëhesh barrë askujt, është adhurim. Profeti a.s. ka thënë: "Varfëria është thujse mohim". Sepse ajo është sprovë e madhe. Prandaj njeriu duhet të dijë të mjaftohet me atë që ka dhe për të qenë një besimtar i mirë nevojitet që çfarë ka të dijë ta përdori siç duhet, duke u ruajtur në radhë të parë nga israfi/harxhimi i tepërt. Në një ajet kur'anor thuhet se Allahu nuk i do ata që harxhojnë me tepri. (En'am, 6/141). Po ashtu, Profeti a.s. jep myzhdën se kush ruhet nga israfi, s'ka për të rënë asnjëherë në gjendje të keqe ekonomike.

Ndërkohë, të pasurit duhet të dinë të shfrytëzojnë këtë mirësi duke dhënë zekatin, si një detyrim karshi Allahut dhe njerëzve në nevojë. Allahu i Madhëruar thotë: **"Nëse më falënderoni, atëherë do t'ju shtoj mirësitë"** (Ibrahim, 14/7). Falënderimi për pasurinë bëhet duke dhuruar prej saj.

Pavarësisht atyre që përmendëm më sipër, thesari më i çmuar që posedon njeriu është dhuntia e pestë e përmendur në këtë hadith, JETA. Por edhe kjo vjen një ditë dhe na ikën nga duart. Çdo gjë që mendonim se ishte me

të vërtetë e jona do të na braktisë. Allahu na ka dhuruar një jetë të tërë për ta shfrytëzuar. Ajo, në fakt, është e shkurtër, aq e shkurtër sa nuk ia vlen të kapeshe pas saj, as të zemërohesh me askënd dhe as që të këmbëngulësh në mohim ndaj ekzistencës së Zotit. Por mund të fitojë shumë lehtë një vlerë të paçmuar me anë të mënyrës se si e jetojmë atë. Prandaj këtu llogaria dhe përparësitë fitojnë rëndësi. Profeti a.s. shprehet kështu: "Gjatë gjithë jetës tri gjëra e ndjekin njeriun: Pasuria, familja dhe veprat e tij. Në derën e vdekjes dy prej tyre e braktisin atë dhe njëra vazhdon ta shoqërojë. E braktis pasuria për të cilën ai është stërmunduar ta fitojë. E braktis edhe familja pa të cilën ai nuk ia bënte dot dhe për të cilën ka punuar gjithë jetës, por nuk e braktis vepra e tij, e cila e ndjek besnike deri në llogaridhënie, e mirë apo e keqe qoftë ajo."

E pra, jeta na jep mundësinë që të kthjellohemi në çështjen e qenies sonë dhe ekzistencës së Zotit, si dhe të pasurohemi me vepra të mira, sepse pas vdekjes nuk ka më kthim.

"Atje, ata do të thërrasin: "O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë." (Atyre do t'u thuhet): "Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijoni (dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!" (Fatir, 35/37)

Zoti i Frikës apo i Mëshirës - Një reflektim mbi ligjërimin fetar, shpirtin njerëzor dhe perceptimin tonë rreth Zotit



Hap telefonin dhe shfleton nëpër rrjetet sociale. Një video pas tjetrës, një predikim pas tjetrit. Flitet për zjarrin e xhehenemit, për ndëshkimin hyjnor, për gabimet që çojnë drejt humbjes. Kalon më tej dhe gjen të njëjtin ton, të njëjtin ritëm, të njëjtën gjuhë që përsëritet pa pushim.

Pa e kuptuar, kjo bëhet pjesë e përditshmërisë sonë. Kjo bëhet gjuha që konsumojmë, mënyra si flasim për Zotin dhe si e përfytyrojmë Atë. Në këtë rrjedhë të pandërprerë mesazhesh, edhe të rinjtë tanë mësojnë të besojnë, të ndjejnë dhe të lidhen me fenë.

Por çfarë imazhi po ndërtojmë kështu për Zotin? Dhe çfarë thotë kjo për mënyrën se si po e jetojmë dhe po e përcjellim besimin?

Kjo formë ligjërimi nuk është e izoluar vetëm në hapësirën fetare. Ajo zhvillohet brenda një konteksti më të gjerë, ku frika është bërë një nga gjuhët dominuese të komunikimit, sidomos në rrjetet

sociale. Nga paralajmërimet për zhvillimet globale, të ushqimi, shëndeti, teknologjia apo mënyrat e rritjes së fëmijëve, shpesh na paraqiten skenarë alarmues, që synojnë të tërheqin vëmendjen dhe të krijojnë një ndjenjë urgjence.

Në kohë pasigurie, frika duket se ofron një lloj sigurie të rreme: ajo jep përgjigje të shpejta, ndan botën në të sakta dhe të gabuara dhe krijon ndjesinë se kemi kontroll mbi atë që na rrethon. Frika nuk është vetëm emocion, është edhe strategji komunikimi. Ajo nuk informon vetëm, ajo mobilizon. Por pikërisht kjo logjikë e thjeshtuar dhe e ngarkuar emocionalisht depërton edhe në ligjërimin fetar, duke e kthyer atë nga një hapësirë reflektimi dhe kuptimi në një hapësirë paralajmërimi dhe frike.

Në shumë ligjërimi fetare sot vihet re një ton i fortë paralajmërues, madje kërcënues. Zoti shpesh paraqitet si një autoritet që pret gabimin, që numëron

shkeljet dhe që është gjithmonë pranë ndëshkimit. Kjo qasje mund të përshkruhet si një formë e asaj që në pedagogji njihet si "pedagogjia e frikës". Një mënyrë edukimi që mbështetet në frikë, kontroll dhe ndëshkim, në vend që të mbështetet në kuptim, marrëdhënie dhe përgjegjësi të brendshme.

Qasje të tilla janë kritikuar prej kohësh në pedagogjinë moderne, sepse prodhojnë bindje sipërfaqësore, por jo zhvillim të vërtetë të brendshëm. Ato mund të krijojnë rregull, por jo domosdoshmërisht kuptim; mund të prodhojnë bindje të jashtme, por jo lidhje të thellë. Prandaj pyetja thelbësore mbetet: a është ky vërtet imazhi i Zotit që na japin burimet tona fetare, apo është një pasqyrim i mënyrës sonë të të kuptuarit dhe të përjetuarit të fesë?

Kurani e fillon pothuajse çdo sure me fjalët "Bismil-lahi'rr-Rrahmani'rr-Rrahim", në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Mëshira nuk është një atribut dytësor; ajo është thelbësore. Edhe në traditën profetike gjejmë një theks të vazhdueshëm mbi faljen, butësinë dhe mëshirën. Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) përshkruhet si "mëshirë për botët" (21:107), jo si një figurë që ushqen frikë të vazhdueshme. Megjithatë, në praktikë, shpesh theksohet e kundërta.

Nëse imazhi që kemi për Zotin është ai i një "ati të zemëruar", që numëron gabimet dhe pret momentin për të ndëshkuar, atëherë duhet të ndalemi dhe të reflektojmë: çfarë tregon kjo për ne? Sepse imazhi i Zotit nuk është vetëm një çështje teologjike. Ai është thellësisht psikologjik dhe pedagogjik. Mënyra se si autoriteti përjetohet dhe mësohet shpesh ndikon në mënyrën se si përfytyrohet edhe Zoti: si i afërt apo i largët, si i mëshirshëm apo ndëshkues.

Një Zot që perceptohet si i ashpër dhe ndëshkues prodhon shpesh një besimtar që jeton me frikë, faj dhe pasiguri. Një besimtar që nuk vepron nga bindja e brendshme, por nga ankthi i ndëshkimit. Një besimtar që e sheh fenë si barrë, jo si burim kuptimi dhe qetësie.

Kjo nuk është vetëm një çështje individuale. Është një çështje edukimi.

Çfarë lloj edukimi fetar po ofrojmë? Dhe çfarë lloj njeriu po formojmë?

Nëse edukimi ynë fetar mbështetet kryesisht në frikë, atëherë rrezikojmë të krijojmë individë të bindur në sipërfaqe, por të shkëputur në thellësi. Individë që ndjekin rregulla, por që nuk e ndejnë kuptimin e tyre. Individë që mund të jenë korrektë në formë, por të zbrazët në shpirt. Në këtë kuptim, "pedagogjia e frikës" nuk është vetëm problem teologjik, por edhe etik dhe shoqëror. Ajo formëson jo vetëm mënyrën se si besojmë, por edhe mënyrën se si jetojmë dhe si lidhemi me njëri-tjetrin.

Një hadith i njohur thotë: "Unë jam ashtu siç më mendon robi Im." Edhe pse ky hadith nuk konsiderohet ndër më të saktët në aspektin teknik, ai mbetet një thirrje e fuqishme për reflektim. Imazhi ynë për Zotin nuk është i parëndësishëm; ai ndikon drejtpërdrejt në përvojën tonë fetare. Nëse e shohim Zotin si të pamëshirshëm, atëherë edhe marrëdhënia jonë me Të bëhet e tillë: e tensionuar dhe e mbushur me frikë. Por nëse e shohim Zotin si burim mëshire dhe drejtësie, atëherë besimi mund të bëhet hapësirë çlirimi, rritjeje dhe transformimi. Kjo nuk do të thotë të mohojmë dimensionin e drejtësisë apo të përgjegjësisë në fe. Frika (hauf) ka vendin e saj, ashtu si edhe shpresa (rexha). Por kur frika bëhet elementi dominues, ajo nuk edukon, ajo paralizon.

Ndoshta sfida jonë sot nuk është thjesht të përsërisim tekstet, por të reflektojmë mbi mënyrën se si i lexojmë dhe i përcjellim ato. Jo vetëm çfarë themi për Zotin, por si flasim për Të. Sepse në fund, mënyra se si flasim për Zotin tregon shumë për mënyrën se si e kuptojmë veten.

Dhe ndoshta pyetja më e sinqertë që mund t'i bëjmë vetes është kjo:

A po i afrojmë njerëzit me Zotin apo po i largojmë ata prej Tij përmes frikës?



HAXHI ËSHTË M'Ë MADHEJA PASQYRË PËR DEMOKRASINË MUSLIMANE



Si dihet prej së gjithësh për të mbushur detyrën e haxhit, çdo musliman i pasur një herë në jetën e vet shkon në Meqqe.

Për mot në Meqqe kohën e haxhit nga an' e anës, nga çdo komb mblidhen me qindra mijë njerëz. Si mbretit ashtu dhe të varfrit pa patur aspak ndryshim veshin vetëm nga një ihram (veshje e veçantë) edhe karos e z bathët dalin n' Arefat krah më krah një mbret me një të varfër edhe kështu me një demokraci të thjeshtë, me një ultësi të naltë, me një shpirt të qetë, me një zemër të pastër i luten Zotit duke thirrur në një zë të përbashkët të gjithë "Lebbejq".

Çudi e madhe se duke e ndodhur qindra mijë njerëz në lloje gjuhësh as njëri-tjetrit si bëzon, as njeri tjetrin s' e nget, po me një disiplinë të mrekullueme, me një demokraci të pashembullt i luten e i falen Zotit.

Këtu në haxh shihet qartazi vëllazërija e plotë, dashurija e vërtetë muslimane, të cilën disiplinë e demokraci të mrekullueshme e pohojnë dhe më të mëdhenjtë botëshëtisë europianë.

Kjo demokraci muslimane, jo vetëm në haxh, po edhe në çdo falishtë shihet.

Si Pejgamberi a.s. ashtu edhe shokët e tij si në Arefat edhe në çdo mbledhje pa vërë re aspak shkallën e njëri-tjetrit m'i madhi rrinte krah më krah me më të voglin, dhe bisedonin

bashkë pa një diferencë.

Muhamed Mustafaj, duke qenë m'i i mençmi i gjithë botës, m'i mbarushmi i gjithë profetëve edhe në punrat më të vogla bisedonte me shokët edhe shumë herë qëllonte që punonte pas fjalës të shokëve, e cila i pëlqente më fort. Vallë, a ka m'e madhe demokraci?

Halifeja i dytë Umeri, një ditë duke e mbajtur fjalën e dhënë në minber tha: Kush që të shohë një shtrembësi ndaj meje le të ma ndreqë". Ahere një prej xhematit i përgjigjet: "Në qoftë se shohim do një shtrembësi prej teje ahere ta ndreqim me shpatë". Umeri mbi këtë fjalë e sipër lavdërojë Zotin duke thënë: "Lavdi paç o Zot! Kur shoh se nga shokët paskam njerës që ma ndreqkan gabimin". Vallë a ka m'e madhe demokraci se kjo?

Muslimanizma bazohet në tri sende: 1) Drejtësi, 2) Njësi (Musavat), 3) Vëllazëri e njëjtë.

Të tjerët kujtojnë se fajet i ka muslimanizma, po s' është ashtu, faji është se nuk jemi muslimanë si duhet.

Ebu Xhehli edhe shokët nga shkaku i demokracisë të plotë nuk u futën ndër flamurin e Muhamed Mustafajt a.s.

H. ALI

"Zani i Naltë, Nr. 9, Qershor 1924



Grueja në myslimanizmë

Kurani tuej e përdorë fjalën erhâm kundrejt grues e tuejlidhë këtë fjalë me një "vavi-atife" me propozicionin e pastajshëm, çfaq një parim qi lypsen volume për koment të tij. Zoti nepër këtë ajet urdhnon: Nderoni me pervûjtni grât-erhâm-qi ju bartin juve. Në këtë ajet kemi shumë pika qi lypsen marrë para sÿshë. E para: Përparandë as një reformator Besimit, asnjë pejgamber, as një kryetar feje e as një libër i shëjtë nuk i ka kumtue nierzimit ndonji porosi qi gravet duhet me i bâmun nderim.

Urdhni qi në këtë rasë leçiti pejgamberi i ynë Hazreti Muhammedi asht mâ i pari e mâ i plotsuemi. Grât qi mâ parë përdorëshin si kafshë, për mbas këtej do të gjëjshin e nderimin e meritueshëm pranë gjithë nierzimit. E jo vetëm kaq: Edhe Perendija, si për ç' do nieri qi asht n'udhë të tij, përdorë dhe kundrejt gravet po atë fjalë nderimi. A mundet me iu dhanë grues një pozitë mâ e naltë se kjo. Me një fjalë Kurani tuej na vue në njën' anë perlim ndigjesen ndaj Zotin, në tjetrën ânë na vën detyrë nderimin ndaj gruen.

Sic' thamë për gruen Zoti përdorë dhe fjalën tak vâ. Randsin e kësaj fjalë mund t'a kuptojnë vetëm ata qi njohin gjuhen ara bishte. Kjo fjale s'ep sallte kuptimin e fjalës hurmet (nderim). Prandëj me këtë fjalë duhet

të kuptojmë jo vetëm nderimin ndaj gruen, por një nderim të tillë qi të jetë mâ i pervûjtë e mâ i pastër. Nepër këtë konceptin në jetën e grues u bâ një revolucion i madhnueshëm.

Brahmanët e Budistët qi mbaheshin si tepër fetarë priftnit krishtënë të kuvendëve qi dalloheshin në devocion e së fundi edhe ebrejt qi konsiderojshin vehten për një popull i zëgjedhun e mbajshin këta fëmnen për një plaçkë të ndyjet qi nuk meriton kurrfarë nderimi. Por Muhammedi qi leu (lindi) në mes të një populli qi vorronte për së gjalli fëmnat edhe ato qi teprojshin i përdorte si një mjet shfrimit epshuer, me një herë, me zanin e tij të naltë predikoj menyren mâ të thjeshtë të Besimit edhe nderimin e grues; e këtë predikim të tij e përsriten edhe shekujt.

Po; Zoti asht krijuesi i vërtetë i gjithsis. Por grueja ka një detyrë për me ia

veshë nieriut formen e tij nierzore. Prandëj Perendija e ka naltsue gruen në ma të naltën shkallë.

Pika tjetër me randësi e ajetit asht: përdorimi i fjalës erhâm në vend të fjalës së grues. Në përdorim të kësaj fjalë asht marrë para sÿshe mâ i nalti e mâ i fisnikshmi qellim: anallëku. Nierzët janë të detyruem me nderue gruen me mâ të madhin nderim përse ajo do të bâhet nânë, do të vuejnjë nepër mjerime, do të bajë mjaftë flije për kërthinin qi do të bartin në bark.

Duhet t'a ndjshin ndjeksat e Qerishta's, Buda's e të Mesit's këtë knmtim të Hazreti Mohammedit. Mjerisht se e ndijnë shumë vonë, mbas shumë shekujshë. I madhi Muhammed kishte mbetë pa nânë tuej këndë endë gjashtë vjeç. Me gjithë këtë, aj as këtë kohë të vogël nuk e kishte kalue në parzmë të nânës; por tu një kujdestare e tij. Vetë pejgamberi kishte lé mbassi i kishte vdekë i atij; Don me thanë se aj qyshë kalama kishte mbetë i pà babë e i pà nânë. Me gjithë këtë fëmi jetim Zoti i Lum vetë Dijenija hyunore e kishte dergue me i mësuem nierzimit nderimin ndaj prindin e ndaj gruen.

Buda lën t'amen, Mesija shqypton se nuk kishte mâ çka t'i bante s'âmes e Mohammedi, i pà nânë e i pà babë, kumton urdhnin e Zotit në nderim të prindvet e të grues e nuk mjafton me kaq por shprehë edhe ndisitet e zëmërës së vet të dhimbshme: El' Xhennetu tahte akdamil' ummehât (Xhenneti nën kambë të na-

navet). Xhenneti asht qellimi kryesuer i besimtarevet: mekanizma e gjithë punëve të mira. Kët lumni, po, kanë qellim të lutunat, te falunat (n jazë e nemazë), agjinimet e flijet (kurbanët) e Bajramit.

Ky hadith i Hazreti Mohammedit vën nën kambë të nanavet Xhennetin, idhealin mâ të plotnuem të lumnis. Kush i kà nderue mâ tepër se kaq nanat? Muhammedi u kà dhanë po këtë pozitë nderimi edhe tezevet.

Thuhet se një ditë vojtë para Muhammedit një nieri edhe i rrefej se kishte krye një mkat të madh, edhe kërkoi mënyren se si m'u liruem prej tij. Muhammedi e pyeti:

- A kë nânë?

- Jo.

Po teze?

- Po, o i dërguemi Perendís.

-Atëherë bânë një të mirë asaj, se mundet që Perendija t'i falë mkatet. Kurani mbasi urdhnon me ajetin e sipërm nderimin e nanavet, vën edhe këtë porosí: "Zoti ju ka kurdoherë nën vretje".

Kjo barrë na u vue prej të madhit Zot me qellim që dashtnin prindore mos t'a shlyjmë kurrnjherë prej zëmret edhe kur tërritemi, e jo vetëm për vogjili, kur kujdesi i nânës e dhimbsunija e saj asht prore mbi në.

Pjesa e fundit e ajetit qorton një ves të keq që ishte i përhapun n' Arabi aso kohe.

Arabët shpërdorshin për dobí të tyne pasunin e jetimavet. Kur jetimët ishin fëmna, mytevelit i merrshin ato me pà-hir; e kështu tuej i zotnue ato, përzijshin me pasuni të vet edhe pasunin e tyne. Si Rromakët e hershëm a po si Inglizët para tridhetë vjetësh edhe arabët i trejtojshin grát e martueme porsí kalamâj. Burrat bâheshin zotnuesat e pasunivet të gràvet të tyne. E myslimanizmi para tremdhet e sá shekujvet deklaroi se pasunija e grues, edhe e pá-kurrkënd kjo kjoftë, nuk duhet çenuem e damtuem nepër kurrfarë pretekstit. Për veç këtij ajet ai morrëm prej Sure'-i Nisa's ka 'dhe shumë ajete tjera në Kurán të ladueshëm që bâjnë fjalë në gruen. Shum janë reformat që në jeten fëmnore ká pertrim myslimanizmi. Æsht përmirsuem ç' do, fazë nepër të cilën përshkohet grueja: si fëmi, si vajzë, si shoqe e si nânë. Në ç' do shteg të jetës i æsht siguruem grues e drejta e asht mprojtun interesa e saj. Në veprimet reciproke të burrit me gruen, grues i janë siguruem interesa më të mdhaja se të burrit edhe janë vuem rregulla që njohin nderimin e fëmnës.

Duhet të dihet se myslimanizmi nuk asht filosofi mendtare ose një besim dogmatik; të gjitha bazat e myslimanizmit kanë më vehte posibilitetin veprues; janë shpjeguem se si mund të veprohet mbi këto baza. Në sheriatin islam ká parime etiket (esasati-ahlakije) shumë të mrekullueshme; ashtu që asht siguruem edhe për- mbarimi i tyne.

Një ndër sherbime që bânë myslimanizmi kje me shlye zakonin e mbrapshtë të futunit në dhe të foshnjevët. N' Arabi e ndër vise tjera ishte përhapun vesi i shemtueshëm i gjakderdhjes të nierit për hir të hyunivet të rrëjshme e i mbyttes së foshnjevët. E grát ishin më të dhimshmet therore të këtyne legjendavët e mizorivët

Kuráni na lajmon se, "Kur i lajmojshin ndokujt se Zoti i kishte falë një bi, fytyren e tij ia qarkonte një hije e zezë mjerimi edhe u deshpronte tepër e medje edhe u turpnonte, tuej mëndue se atë pjellë të pá fajshme a do t'a vorronte a po do t'a lënte gjallë për me vuejtun nën mizori". Sa keq gjykojshin këta nierze fatkeqë! E këtyne të mjerëvet Perendija u ep sihariqin me këto fjalë të madhnueshme: "Ne i mbytni fëmijët t' uej prej frige se ata do të t'iu rrijnë pá hanger, shporiniu këtij mkat të madh, se Perendija si ju ashtu 'dhe atyne do t'iu apin ushqimin (rizkun)". Një ditë në mes të Hazreti Muhammedit e të Kajsi Temimit rrodh ky fjalim; kur i Miri Pejgamber mbante në prehen një vajzë të vogël:

- O Muhammed! I kujt asht aj fëmi që po përkëdhelë ashtu?

- I ëmi, përgjegjet pejgamberi.

- Po t' ishte aj fëmi i ëmi, ia pret Kajsi, nuk e përkëdhelshe ashtu, por e futshem në dhe për së gjalli.

- Prà ti, i thote zëmër-bardhi pejgamber, jë një fatzi i madh; Zoti të ká mungue ty një dashtni nierzore, më të madhen dhanti që aj i lum ia dha nierit.

Felligshtín (débauche-fuhës) që plandosi në më të përfrigueshmen dekadencë gruen, myslimanizmi e ndaloj rreptsisht edhe me kurr një mënyrë nuk e lëjoj këtë. Urdhnon po kjo fé myslimane: Bini njëqind shkopi burrit e grues, të xânun në kurvni. Mos t'iu vijë aspak mëshirë në zemër në zbatim të këtij urdhnit të Perendís.

Arabët si katolikët e atëhershëm e si rromakët e dikurshëm as vejushat as robneshat nuk i lëjshin m' u martue; në vend që myslimanizmi lëjoj të martoheshin vejushat edhe iu dha vend robëvet në mes të nierzëvet të lirë, tueji a njoftun atyne të drejtat nierzore.

Revista "Zani i Naltë", nr.8, Tetor 1925.



Këshilla



1. Mos fol shumë për veten, sepse librat e hapur nuk tërheqin lexues!

2. Mos i ndërto burg vetes me mendimet e njerëzve për ty, nuk të njeh askush më mirë sikurse vetja dhe kjo mjafton!

3. Shfrytëzoji çastet e pritjes duke bërë istigfar!

4. Nëse nuk ke diçka t'u japësh të tjerëve, atëherë jep lëmoshë me një fjalë të mirë e buzëqeshje të sinqertë dhe sillu me njerëzit me moral të mirë!

5. Nëse të godet brenga dhe mërzia, vetëm thuaj Estagfirullah (Kërkoj falje prej Allahut).

6. Kush do që gjoksi t'i zgjerohet, mëkati t'i falet, pikëllimi t'i lehtësohet dhe brenga t'i largohet, le t'i shtojë salavatet mbi Pejgamberin, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin për të!

7. Mbaje mend, për t'i ndryshuar gjërat patjetër duhet që ti të ndryshosh!

8. Mos e hap zemrën tënde, derisa ta vërtetosh pastërtinë e atij që do të banojë në të!

9. Mos e braktis namazin asnjëherë, sepse nëpër varreza janë me miliona njerëz që shpresojnë të kthehen në jetë dhe të bien në sexhde, madje ta bëjnë edhe vetëm se një sexhde!

10. Jeta vazhdon pavarësisht se a qesh apo qan, prandaj mos bart me vete brenga që s'përfiton nga to!

11. Kurani është vatan, i cili e shpëton dhe çliron çdonjërin që dynjaja e ka lodhur dhe rraskapitur!

12. Ulja e autoritetit të të tjerëve nuk të ngrit asnjëherë!

13. Mos i zemëro prindërit e tu për t'i kënaqur të tjerët, sepse të tjerët nuk e harxhuan jetën e tyre për ta ndërtuar jetën tënde!

14. Nëse e ke mundësinë që ta bësh të lumtur dikë, qoftë ajo edhe me një fjalë, mos hezito!

15. U larguam shumë nga Kurani, e pastaj po pyesim se pse gjokset tona po na ngushtohen pa asnjë shkak!

16. Ai që të shet një herë e ka mundësinë të të shesë edhe një mijë herë të tjera, andaj mos e nënvlerëso veten!

17. Mos e harxho kohën tënde për ta arritur dashurinë e disa personave, po atë harxhoje me ata që të duan me të vërtetë!

18. Mos e vono bërjen e veprave të mira deri të nesërmen, se e nesërmja do të vijë mirëpo ti ndoshta më nuk je!

19. Kapuni fort për ata që i doni dhe shprehjuani dashurinë tuaj, faljuani mangësitë e tyre, sepse një ditë ju apo ata do të largoheni dhe në zemrat e tyre do të mbeten fjalët dhe përmallimi!

20. Mos e mposht askënd për ta lumturuar veten, mos i bëj padrejtësi askujt për t'i shfajësuar gabimet e tua, po mundohu që lumturinë tënde gjithmonë ta ndërtosh larg lëndimit të njerëzve!

21. Mos u tall me ëndrrat e njerëzve, sado të çuditshme që janë dhe mos i braktis ëndrrat e tua, sado të rënda që janë, jeta s'ka shije pa ëndrra!

22. Çdo moment kur veten në të e gjen të heshtur kërko

falje prej Allahut (thuaj Estagfirullah).

23. Pavarësisht se sa nijetin e ke të pastër, s'ke për të shpëtuar nga mendimet e këqija të njerëzve!

24. Kujdesu mirë për ata që gëzohen për gëzimin tënd dhe pikëllohen për pikëllimin tënd, ata janë që e meritojnë një vend të posaçëm në zemrën tënde!

25. Mos u zemëro, nuk dëmtohet nga zemërimi yt askush përveç teje!

26. Bëhu i tillë që kush të sheh të lutet për atë që të edukoi!

27. Ditën e bukur bëje vetë dhe mos prit që bukurinë e ditës sate ta bëjë dikush tjetër.

28. Dielli nuk pret që ti të zgjohesh që të të dhurojë dritë, as lulja nuk pret që t'i afrosh që të të dhurojë erë, po ti bëhu sikurse ato dhe nxito t'u ndihmoh atyre që i ke përreth!

29. Harresa është begati dhe kush do ta ketë mendjen e qetë, le ta harrojë atë që e gjen prej të tjerëve kundrejt tij!

30. Lodhjet e jetës janë të vazhdueshme dhe ato prej teje nuk e dëshirojnë pikëllimin, ato prej teje kërkojnë që ti të ndryshosh, të bëhesh më i durueshëm, të mos ndalesh, por të ecësh para!

31. Tri gjëra patjetër duhet që të sistemohen në mendjen tënde: Nuk ka shpëtim nga vdekja, nuk ka rehati në dynja dhe nuk mund t'u shpëtosh fjalëve të njerëzve!

32. Mos u mërzit prej sjelljeve të krijesave kundrejt teje, po shikoji sjelljet e tyre me Krijuesin!

33. Nëse dështon një herë, vërtetojua atyre se ti je i suksesshëm.

34. Mbylle dritaren që të dëmton, sado që pamja të jetë e bukur!

35. Mos u dëshpëro, vetëm mundohu ta përmirësosh atë që të tjerët e shkatërruan!

36. Përmirësoje nijetin tënd, Allahu do ta përmirësojë gjendjen tënde, shpresë për tjetrin mirësi, edhe ajo do të vijë për ty!

37. Harroje të kaluarën, por me të mos e harro mësimin që e more!

38. Nëse ndokush të bën të qash dhe të zbresin lotët, mos mendo se je i dobët, po dije se lotët janë argument se ti je njeri që ke ndjenja.

39. Suksesi vjen me fjalën mundem, kurse dështimi vjen me fjalën nuk mundem!

40. Mos u pikëll nëse jeta të ngushtohet, ndoshta Allahu është përmalluar për ta dëgjuar zërin duke e thirrur në lutje.

41. Në çdo vend lër gjurmë që aludon në ty!

43. Njerëzit do të flasin për ty pa marrë parasysh a bërë diçka apo jo!

44. Bëhu gjithmonë urë përmirësuese mes njerëzve dhe i mjeri ti nëse bëhesh pengesë mes tyre që ata i ndan!

45. Lërjani krijesat Krijuesit!

46. Nëse do të jetosh jetë të qetë dhe të rehatshme, mos ki zili, mos urre dhe mos u përkujdes për dynjanë!

*Poezi kushtuar
Profetit Muhamed
a.s.*



Poezi kushtuar Profetit Muhamed a.s.
Ti moj erë e jugut që vjen nga Meqeja,
Nga vend i bukur ku ndodhet Qabeja.
Vallë ç'na ke sjellë ti nga Medineja?
Atje është Resuli edhe Sahabeja.
Ai është diell shokët yje janë,
Çdo dritëz që japin prej Atij e kanë.
Ai është burimi këta rryma janë,
Ujët si argjendi prej Atij e kanë.
Na i dhe evliat nahen si bilbili
I ka dehur era e këtij trëndafil.
Sillem përreth tij, digjem porsi flutur
Digjem për Nebiun, për nurin e bukur.
Vejsel Karaniu gufoi porsi valë
Për Resulin shkuli çdo dhëmb e dhëmballë.
Ibrahim Et'hemi flaku mbretërinë
U degdis në pyje për Ahmet Nebij.
Ligjëron romuza fyelli Mevlana,
Këndon bukurinë Ahmet Mustafa.
Shahu Nakshibendi kur e vështroi nur
Bota, tha, për mua s'vlen një kokërr grurë.
Mujdin Arabiu pse tha "enel flak"
Për ty ja Resul seç u mbyt në gjak.
Imami Azami nuk lëshon fetva
Vdiq syrgjyn i mjeri për Ty Mustafa.
Mesurin Hallaçin vetëm për një fjalë
Për ty ja Resul e rropën të gjallë.
Çohu ja Resul kush të ka ardh' mbi varr
Ahmet Rufajja të është ndezur zjarr.
Fahrudin Raziu dritë po kërkon
Se pa dritën tënde pena s'i punon.
Dridhet Idaiu! Mend e mia vanë
Si gjemi e mbytyr në det të paanë.
Vanë filozofët dhe s'u mbeti bojë
Ç'është ky mbret nga doli, që mbylli çdo gojë
Ky në shkollë s'ka qenë, dituri ku mori
Profesor s'pati, profesor nxorri.
Baltë i jemi Hajdarit Qerarit
Fatimes, së bijës Ahmedul Muftarit.
Baltë i jemi bërë ne imam Hysenit
Sadikut, Farukut, Osman Dhinurejnit.
Det'i shpirtit tim tani po merr valë
Lemë të shoh Resul, o Zot të qofsha falë.



BOTIMET KMSH **ZËRI QË VJEN NGA MINBERI**

Zëri që vjen nga minberi

Regjistri i emrave të 1732 klerikëve shqiptarë, 1990 - 2025



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

“

NJË KATALOG I PUNUAR ME RASTIN E 35 VJETORIT TË LIRISË SË BESIMIT, I CILI PËRMBAN REGJISTRIN E 1732 KLERIKËVE SHQIPTARË, 1990- 2025. BURIMI I LISTËS SË EMRAVE ËSHTË MARRË NGA MYFTINITË E SHQIPËRISË.



WWW.KMSH.AL



BOTIM I RI